



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Informatikë Biznesi”
Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda BAROLLI

Prof. Asoc. Dr. Jonida TETA

Janar / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Informatikë Biznesi"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në "Informatikë Biznesi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 225, datë 04.06.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 357, datë 23.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 283, datë 30.05.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	23 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	- 2019-2020 - 136 studentë; - 2020-2021 - 131 studentë; - 2021-2022 - 166 studentë;
19	Komente / të tjera:	-


TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Biznesi" është një program studimi me kohë të plotë, me 180 kredite, që ofrohet në 3 vite akademike, në përfundim të të cilit jepet diploma Bachelor në "Informatikë Biznesi", e regjistruar sipas Urdhërit Nr. 357, datë 23.10.2020, Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Biznesi", me kohë të plotë, të Universitetit "Mesdhetar të Shqipërisë". Programi është hapur me Urdhër Nr. 225, datë 4.6.2013 të MASH, dhe është akredituar me Urdhër Nr. 283, datë 30.05.2016 të MAS, për një kohëzgjatje 6 vite. Sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr.6/1, datë 19.05.2017 të Shkollës së Lartë Private (sot Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë) programi konfirmohet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike (FSHE) të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë (UMSH).

Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi" është Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor të FSHE.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se ky program ka si qëllim kryesor përgatitjen e studentëve si specialistë të informatikës të profilizuar në fushën e ekonomisë, me njohuri bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, rrjetave kompjuterike, strukturës së të dhënave, por edhe në financë, kontabilitet, menaxhim, ekonomiks dhe lëndë të tjera ndërdisiplinare. Dijet që marrin studentët në përfundim të këtij programi studimi karakterizojnë profilin e tij dhe garantojnë ofrimin e dijeve dhe aftësive të nevojshme në përputhje me kërkesat e tregut të punës, lehtësojnë punësimin e të diplomuarve, duke ju siguruar atyre mundësi punësimi si në sektorin publik edhe atë privat, si specialistë ekonomie me njohuri në fushën e informatikës apo informaticienë me njohuri në fushën e ekonomisë.

Ky raport u përgatit nga ana e Grupi të Vlersimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të ri-akreditimit për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi".



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Mbështetur në Vendimin Nr. 157, datë 16.05.2016, Për Akreditimin e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Informatikë Biznesi”, të Institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, Këshilli i Akreditimit vendosi të japë vlerësim pozitiv për këtë program studimi me rekomandimin e mëposhtëm:

1. Institucionit i rekomandohet të rrisë numrin e kompjuterave në laborator për këtë program studimi;

GVJ konstaton që institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të këtij program studimi 3 laboratorë të pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe specifike në përmbushje të kërkesave të lëndëve të këtij program studimi. Këta laboratorë përmbushin kërkesat e programit përse i përket numrit të kompjuterave dhe programeve të instaluara në to. Në këtë aspekt GVJ konkludon që **ky rekomandim është përmushur plotësisht.**



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” të ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) është përgatitur nga ekspertët Prof. Asoc. Dr. Jonida Teta dhe Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli të kontraktuar nga ASCAL.

Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) grupi i ekspertëve u mbështet në dokumentat që u aksesuan nëpërmjet shërbimit AMS të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit për këtë program studimi dhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të UMSH. Gjithashtu informacionet dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e këtij raporti u plotësuan edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të ekspertëve gjatë vizitës 2 ditore në institucion, si dhe nëpërmjet intervistave të zhvilluara me personelin akademik dhe administrativ si dhe studentët. Me kërkesën e GVJ pas vizitës në institucion u ngarkuan në sistemin AMS edhe 3 dokumenta të tjera plotësuese.

Për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit grupi i ekspertëve është mbështetur në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Për hartimin e RVJ ekspertët janë bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përputhja e tyre me kriteret e kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit “Bachelor” në IAL në Shqipëri. Gjatë vlerësimit GVJ u përqendrua tek plani mësimor sipas aktiviteteve dhe plani mësimor i detajuar, shpërndarja e krediteve dhe orëve krahasuar me kërkesat e VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, përmbajtja e lëndëve dhe literatura që përdoret, përshtatshmëria e personelit akademik në lidhje me këtë program studimi, infrastruktura në mbështetje të programit, mbështetja a studentëve, sigurimi i brendshëm i cilësisë, etj.

Vizitat në institucion u kryen në datat 15.09.2022 dhe 16.09.2022 dhe u asistua nga znj. Endra Velaj, koordinatorja teknike e ASCAL. I gjithë procesi i vlerësimit të jashtëm nga ekspertët u asistua nga koordinatorja teknike e ASCAL znj. Majlinda Demirneli.

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 06.12.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 125/41 Prot, datë 06.12.2022. Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" më datë 15.12.2022, njofton mbi Draft Raportin, nëpërmjet shkresës me Nr. 2016 Prot datë 14.12.2022, “Saktësime mbi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm”. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportin, shprehet si vijon:

Për komentet e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardet VI.4 dhe VI.5,**

GVJ konkludon që Raporti në këto pika nuk ndryshon, sepse konstatimet e dhëna në këto pika nga GVJ nuk rezultojnë të plotësuar siç kërkohen në kriteret dhe standardet përkatëse. Për më tepër referojuni RVJ në paragrafet respektive dhe të mirëkuptohen sugjerimet e dhëna me qëllim vijimin e përmirësimit të cilësisë për këtë program studimi.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë. UMSH ofron një gamë të gjërë programesh studimi të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale, në fushën e shkencave ekonomike, informatike, marrëdhënieve ndërkombëtare, sociale, politike dhe juridike. Të gjitha programet ofrohen në përputhje me misionin e këtij institucioni i cili pohon se “<i>Misioni i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit</i>”. Në përputhje me këtë mision është hartuar edhe programi Bachelor në Informatikë Biznesi, i cili formon specialistë për një nga fushat më me prioritet strategjik të vendit tonë. Ky program nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon në zgjidhjen e sfidave aktuale dhe zhvillimin e vendit. Të gjitha programet e studimit mbështeten tek Statuti i UMSH si shtylla themelore e institucionit, duke ndjekur vizionin e UMSH për të ofruar një arsim cilësor nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor, duke përgatitur qytetarë të angazhuar dhe me integritet, në një mjedis social aktiv dhe në përputhje me interesat kombëtare.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti.pdf, Neni 4</i> https://www.umsh.edu.al/c/14/misioni-dhe-filozofia</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në bazë të Statutit të UMSH, GVJ konkludon se programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, sikurse edhe të gjithë programet e tjera që ofrohen në UMSH, synojnë zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike, nëpërmjet programeve mësimore – shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik, si dhe thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistëve të lartë në fushat e prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të</p>

	<p>vendit. Gjithashtu GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi ka në përmbajtjen e tij lëndë të cilat ndihmojnë në ruajtjen e vlerave akademike e kulturore kombëtare si dhe në formimin e etikës profesionale dhe shoqërore të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti.pdf, Neni 4</i> <i>Evidenca 2: Plani strategjik i IB.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Sikurse e përmendëm edhe në kriterin 1, misioni i UMSH është të ofrojë arsim të lartë dhe veprimtari krijuese në fushat e shkencave ekonomike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike nëpërmjet programeve universitare mësimore – shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor, teorik, metodik e praktik. GVJ konstaton se ky mision përmbushet nga tre fakuletet e UMSH. Programet e studimit që ato ofrojnë janë në përputhje me pikat e sipërpërmendura të misionit të institucionit por edhe me fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti.pdf, Neni 4, Neni 5</i> <i>Evidenca 3: Plani strategjik i UMSH.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Duke ju referuar gamës së gjërë të programeve të studimit dhe diplomave që UMSH ofron në fushat e sipërpërmendura në kriterin 3 (1 diplomë profesionale, 7 bachelor, 6 master profesional, 8 master i shkencave, 1 doktoratë), GVJ gjykon se të gjitha këto fusha do të formojnë specialistë të rinj që do të kontribuojnë në zhvillimit ekonomik në vend dhe në rajon. Gjithashtu specifikisht në lidhje me programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, GVJ gjykon se ky program është ndërdisiplinar dhe ndërthur njohuri të biznesit dhe ekonomisë, me ato të teknologjisë së informacionit, njohuri shumë të kërkuara në tregun e punës sot, duke plotësuar nevojat për specialistë të kësaj fushe në vend, por edhe duke rritur kapacitetet konkurruese të tyre jo vetëm në rang lokal e kombëtar por edhe në tregun ndërkombëtar.</p> <p><i>Evidenca 2: Plani strategjik i IB.pdf</i> <i>Evidenca 3: Plani strategjik i UMSH.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret


Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Sipas Planit Strategjik të programit Bachelor në Informatikë Biznesi, objektivat e këtij programi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të formojë specialistë të informatikës së aplikuar në biznes; - T'u mundësojë studentëve studime të avancuara në këtë fushë; - Të pajisë studentët me njohuri bazë formuese në fushat e bazave të të dhënave, programimit, rrjetave kompjuterike, strukturës së të dhënave, etj; - Ti japë studentëve njohuri shkencore dhe praktike për të përballuar kërkesat e tregut; - Të ndihmojë në rritjen e kulturës institucionale të punës; - Të ndihmojë studentët të zbatojnë njohuritë e marra në sipërmarrje inovatore; <p>GVJ konstaton se këto objektiva dhe gjithë Plani Strategjik i programit është hartuar në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit e mbështetur kjo tek dokumentat strategjike të tij. Sipas Planit Strategjik të UMSH, institucioni synon të jetë motor i zhvillimeve sociale dhe ekonomike të vendit, nëpërmjet njohurive dhe ekspertizës në fushat që ai mbulon, të ofrojë arsim cilësor nëpërmjet dijeve të qëndrueshme të bashkëpunimit, kërkimit shkencor dhe inovacionit.</p> <p>Sistemi i njohurive që ofrohet nga programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.</p> <p><i>Evidenca 2: Plani strategjik i IB.pdf</i> <i>Evidenca 3: Plani strategjik i UMSH.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Mbështetur tek Statuti i UMSH si dhe tek diskutimet me drejtuesit e institucionit, GVJ konstaton se drejtimit akademike prioritar të institucionit janë fushat e shkencave ekonomike, informatike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale, politike. Realizimi i këtyre prioriteteve synohet nëpërmjet përmbushjes së Misionit të përcaktuar në Statutin e UMSH Neni 4. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentave të tjera të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete duke ardhur si një ofertë e natyrshme që kombinon fushën ekonomike me atë të informatikës dhe në</p>

	<p>përshtatje me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti.pdf, Neni 4</i> <i>Evidenca 2: Plani strategjik i IB.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi i ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, është një program studimi i Ciklit të Parë me 180 kredite, i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën shqipe, i organizuar me një kohëzgjatje normale 3 vite (6 semestra, ku çdo vit ka dy semestra). Në bazë të shqyrtimit të dokumentave (Rregullore e UMSH, FSHE, DIFSH) konstatohet që organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje të plotë me fushat e drejtimit akademike të UMSH. Objektivat e programit janë në përputhje me objektivat e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe të Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor, përgjegjës për këtë program studimit.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit, <i>Evidenca 8, "Rregullore e programit Bachelor në Informatikë Biznesi"</i>, GVJ konstaton se në Nenin 4 të kësaj rregulloreje janë specifikuar qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë objektivat formuese të këtij programi. Këto objektiva janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formimi teorik dhe praktik i studentëve, mbi teknologjinë e informacionit dhe implementimi në fushat e ekonomisë dhe biznesit; - Formimi i specialistëve në fushën e Ekonomisë dhe informatikës;

	<p>- Pajisja e studentëve me njohuri të nevojshme për vazhdimin e studimeve të niveleve më të larta apo specializimeve të mëtejshme në profile më të ngushta; Këto objektiva i shërbejnë përmbushjes së qëllimit kryesor të programit që është përgatitja e studentëve si specialistë të informatikës të profilizuar në fushën e ekonomisë, me njohuri bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, rrjetave kompjuterike, strukturës së të dhënave, por edhe në financë, kontabilitet, menaxhim, ekonomiks dhe lëndë të tjera ndërdisiplinare. GVJ konstaton se dijet që marrin studentët në përfundim të këtij programi studimi në fusha të tilla si gjuhët e programimit, arkitektura dhe vlerësim i kompjuterave, sistemet e shfrytëzimit, algoritmikë, strukturë të dhënash të kombinuara me njohuritë në fusha të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë, ekonomiks e karakterizojnë profilin e tij.</p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shqyrtuara si dhe nga bisedat e zhvilluara me drejtuesit e institucionit, GVJ konstatoi se UMSH ka zhvilluar një studim të tregut të punës përpara hapjes së këtij programi studimi, i bazuar tek të dhëna e marra nga fokus grupet, intervistat dhe anketimet, mbi bazë të të cilave ka qartësuar elementët karakterizues programit të studimit, emërtimin e programit, profilet, si dhe mundësitë për punësimin e të diplomuarve. Gjithashtu në bazë të dokumentit “<i>Evidenca 7: Analiza e tregut të punës</i>”, UMSH ka vëzhguar tregun e punës në lidhje me kërkesat dhe punësimin për të diplomuarit në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Ky studim është realizuar me të dhëna periodike për vitet 2015 – 2021 dhe ka shërbyer për të argumentuar vendin që zënë në tregun e punës të diplomuarit e këtij programi. Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur kemi edhe evidenca të numrit të të diplomuarve dhe punësimin real të tyre si në fushën e studimit dhe jashtë saj, për periudhën 2016 – 2022, të paraqitura në tabelën 23 të Aneksit të të dhënave.</p> <p><i>Evidenca 8: Analiza e tregut.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 23: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive,</p>	<p>Duke u bazuar tek Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi si dhe Plani Mësimor, GVJ konstaton se struktura e këtij programi studimi është e organizuar në 5 kategori të lëndëve sipas tipit të veprimtarisë, në të cilat përfshihen lëndët që ofrojnë njohuritë për formimin</p>




<p>shkathësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>e përgjithshëm, ato që ofrojnë njohuritë për formimin specifik karakterizues, lëndët integruese – ndërdisiplinore, lëndët plotësuese dhe diploma/provimi përfundimtar. Sikurse janë përshkruar edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, në Rregulloren e Programit janë përcaktuar qartësisht edhe objektivat formuese të tij.</p> <p>Nëpërmjet kategorizimit të paraqitur në Planin Mësimor si dhe mbështetur tek lëndët e përzgjedhura për secilën kategori, GVJ mendon që komponentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, si struktura e tij, objektivat formues, njohuritë bazë dhe përmbajtja, garantojnë ofrimin e dijeve dhe aftësive të nevojshme në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e të diplomuarve, duke ju siguruar atyre mundësi punësimi si në sektorin publik edhe atë privat, si specialistë ekonomie me njohuri në fushën e informatikës apo informaticienë me njohuri në fushën e ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, të Fakultetit të Shkencave Ekonomike në UMSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, si dhe pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka të punësuar si staf akademik me kohë të plotë dhe të ftuar, një numër të konsiderueshëm pedagogësh të cilët karakterizohen nga një formim profesional i plotë dhe i vlerësueshëm. Specifikisht në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi janë angazhuar ndër vite staf akademik me përgatitje të lartë shkencore që mbajnë titullin Akademik, Profesor si dhe gradën shkencore Doktor.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Aneks 3. Tabela 1</i>), Fakulteti i Shkencave Ekonomike për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 69 pedagogë, nga të cilët 52 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 5 kanë titullin “Profesorë”, 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 15 kanë gradën Dr./PhD, dhe</p>



	<p>25Asistent Lektorë me Msc; dhe 17 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 5 kanë titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 7 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor ka 18 PAE dhe 8 PAK.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, janë angazhuar: rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 28 pedagogë gjithsej, ku 23 PAE, nga të cilët 2 Prof.Dr, 3 Prof.Asoc, 9 me gradën Dr/PhD, si edhe 9 asistente-lektore me Msc, dhe 5 PAK nga të cilët 1 Prof.Dr, 2 me gradën Dr/PhD, si edhe 1 asistente-lektore me Msc.</p> <p>Mbështetur në këta elemente GVJ gjykon se institucioni ka kapacitetet akademike të duhura për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.</p> <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 6; Cilësia e stafit mësimdhënës të programit Bachelor në Informatikë Biznesi</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 4. CV-te e stafit akademik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike është njësi kryesore e UMSH që ofron këtë program studimi. Fusha specifike e këtij programi studimi që kombinon njohuri të informatikës me njohuri ekonomike paraqitet në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore.</p> <p>Njësi bazë gjithashtu që ofron këtë program, Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor është njësi bazë mësimore kërkimore në Fakultetin e Shkencave Ekonomike. Kjo njësi nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disipinat e ekonomisë, menaxhimit, marketingut, sipërmajres dhe informatikës. GVJ konstaton se ka përputhshmëri mes fushës kërkimore e akademike të njësisë bazë dhe asaj të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në lidhje me kodifikimin kombëtar të programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ky program studimi i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, është përgjegjës Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Duke u mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar (Statuti i UMSH; Rregullorja e UMSH; Rregullorja Fakultetit të Shkencave Ekonomike; Rregullorja e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor). GVJ konstaton se institucioni ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe formale mënyrën e funksionimit të njësive përbërëse të tij, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive si edhe bashkëpunimin mes këtyre njësive. Sipas Statutit, çdo njësi bazë dhe administrative ka funksione të mirëpërcaktuara dhe komunikon në një formë të rregulluar me njësitë e tjera. Këto marrëdhënie janë të dokumentuara dhe arshivuara. Gjatë vizitës në institucion, në takimet me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit përgjegjës për këtë program studimi, GVJ u informua se UMSH ka siguruar marrëdhënie shumë të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Ky bashkëpunim pasqyrohet edhe në analizat vjetore të institucionit, njësisë kryesore dhe departamentit.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti.pdf, Neni 4</i> <i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 13: Raporti vjetor i Institucionit.pdf</i> <i>Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>UMSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi. Në dokumentin "Evidenca 10", jepen të listuara bashkëpunimet e UMSH me universitete në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bosnjë-Hercegovinë, Itali, Rumani, Bullgari, Poloni, Spanjë, etj. Gjithashtu marrëveshjet janë nënshkruar edhe me institute kërkimore-shkencore në vend, organizata biznesi të mirënjohura në fushën financiare,</p>

Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

juridike, të teknologjisë së informacionit, etj. Në bazë të këtyre marrëveshjeve institucioni ka zhvilluar një sërë aktivitete duke ftuar ekspertë të fushave të ndryshme dhe lektorë të huaj për leksione të hapura, si dhe ka krijuar mundësi intership-esh dhe praktikash mësimore për studentët e programeve të veta të studimit.

Në Raportin Vjetor të UMSH 2020-2021 theksohet roli i marrëveshjeve të bashkëpunimit të institucionit në zhvillimin strategjik të universitetit, ndërkombëtarizimin, mësimdhënien, kërkimin shkencor, realizimin e praktikave mësimore të studentëve si dhe punësimin e tyre.

Gjithashtu GVJ konstaton se edhe Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor ka një sërë bashkëpunimesh, të cilat janë referuar dhe analizuar edhe në dokumentin "Memo mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit midis DIFSH dhe institucioneve të tjera akademike dhe joakademike". Në këtë raport evidentohen organizimi i tavolinave të rumbullakta të diskutimit, leksionet e hapura, webinar-et, trajnime, etj, të gjitha këto në kuadër të përmirësimit të procesit mësimor dhe shkencor në departament, si dhe në lidhje me programet e studimit që ai ofron.

Evidenca 10: Lista e marreveshje te bashkepunimit te UMSH me institucione te tjera.pdf

Evidenca 11: Memo mbi marreveshjet e bashkepunimit.pdf

Evidenca 12: Marreveshje e Erasmus me universitetin Lasapienza.pdf

Evidenca 13: Raporti vjetor i Institucionit.pdf

Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.

Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, GVJ e mbështet arsyetimin në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit të përmendura edhe më sipër, duke evidentuar më specifikisht marrëveshjet me ato institucione që janë në funksion të përmirësimit të këtij programi studimi të tilla si Akademia e Shkencave, INSTAT, Infosoft Group shpk, CODEIT, SmartWork shpk, Qendra Didaktike Irisoft, Deloitte Audit Abania, Application Management Development, CMD of ETS Tests, etj.

Përsa i përket praktikave mësimore në këtë program studimi, është parashikuar që ajo të shlyhet me orë në auditor, ku studentët realizojnë projekte mbi fushën e programimit në web, bazës së të dhënave, rrjetave kompjuterike, etj. Gjithashtu ata përgatiten për ti prezantuar njohuritë e marra në prezantime në intervista të simuluar, duke mësuar se si të paraqesin CV-në e tyre, të shkruajnë letra motivimi, etj. GVJ


	<p>konstaton se Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, i ka të gjitha kapacitetet akademike për realizimin e këtyre orëve të praktikave profesionale.</p> <p><i>Evidenca 10: Lista e marreveshje te bashkepunimit te UMSH me institucione te tjera.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11: Memo mbi marreveshjet e bashkepunimit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, GVJ nuk gjeti evidencë të trajnimeve të mëtjshme profesionale për studentët e diplomuar, por në diskutimin me drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit u evidentua që institucioni ruan kontakte të mëtjshme me studentët e diplomuar, duke marrë njëkohësisht edhe feedback nga punëdhënësit pranë të cilëve janë punësuar këta studentë. GVJ u informua që në aktivitetet e hapura që zhvillohen nga departamenti në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, ftohen të marrin pjesë jo vetëm pedagogët e rinj, studentët aktualë, por edhe rrjeti i alumnit. Në Raportin Vjetor të Departamentit për vitin akademik 2021 – 2022 janë renditur një sërë aktivitetesh të hapura të lidhura specifikisht me këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 25: Formulari i Studentit ALUMNI.pdf</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni (<i>Rregullore e UMSH, Neni 2 Baza Ligjore, Neni 43 Organizimi i Studimit; Kurrikula e Programit; Plani Mësimor, etj</i>), se programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, është një program i ciklit të parë dhe si i tillë i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me</p>


<p>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>legjisllacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program është i organizuar në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite përkatësisht 60 kredite në total në vitin e parë, 59 kredite në vitin e dytë dhe 61 kredite në vitin e tretë. Në përfundim të studimeve studentët pajisen në total me 180 kredite ECTS dhe pajisen me diplomë Bachelor në “Informatikë Biznesi”. Lëndët në program janë karakterizuar sipas veprimtarive formuese dhe kanë të përcaktuar ngarkesën në auditor, studimin individual dhe numrin e krediteve. Sipas planit mësimor lëndët janë të kategorizuara sipas tipit të veprimtarisë (A-E). Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese përfshihen disiplina të formimit bazë të programit për përgatitje teorike dhe shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 9: Plani mësimor sipas tipit të veprimtarisë</i> <i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Syllabuseve dhe Planit Mësimor të programit të studimit, GVJ konstaton se tërësia e lëndëve të përfshira në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, ofron një mbulim të mjaftueshëm të disiplinave specifike në fushat e informatikës, teknologjisë së informacionit, ekonomisë, biznesit, financë – kontabilitetit, etj. Programi ofron një larmi disiplinash si formimin e aftësive profesionale në programim, menaxhim të bazës së të dhënave, rrjetat kompjuterike, të ndërthurura me njohuri mbi ekonominë, financën, kontabilitetin, marketingun, etj. Objektivat formues të këtij programi janë:</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi teorik dhe praktik i studentëve mbi teknologjinë e informacionit dhe implementimin në fushat e ekonomisë dhe biznesit; - Formimi i specialistëve në fushën e Ekonomisë dhe Informatikës; - Pajisja e studentëve me njohuri të nevojshme për vazhdimin e studimeve të niveleve më të larta apo specializimeve të mëtejshme në profile më të ngushta;



	<p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit dhe më tej të Syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se duke u bazuar tek këto objektiva formues, përmbajtja e programit dhe e lëndëve është hartuar e tillë që të përmbushë këto objektiva dhe ti japë mundësi studentit të përfitojë njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushat e studimit biznes/ekonomi dhe informatikë si edhe ti aftësojë studentët për punësim të mëtejshëm. Ndërthurja e lëndëve paraqitet në përgjithësi e kompletuar për të aftësuar studentët e programit të kuptojnë parimet akademike të të dyja disiplinave.</p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 9: Plani mësimor sipas tipit të veprimtarisë</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (<i>Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit</i>), konstaton se objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është t'u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, rrjetave kompjuterike, strukturës së të dhënave, etj me objektiv kryesor formimin e specialistëve në fushën e Ekonomisë dhe Informatikës. Misioni është t'u ofrojë studentëve njohuri shkencore teorike dhe praktike mbi drejtimet kryesore të zhvillimit të informatikës në ditët e sotme si dhe mbi aplikimin e njohurive të informatikës në ekonomi e veçanërisht në biznes.</p> <p>Për realizimin e këtij misioni dhe objektivave të tij, programi parashikon lëndë të tilla bazë si gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterave, sistemet e operimit, algoritmikë, strukturë të dhënash, rrjetat kompjuterike, etj, të kombinuara me njohuritë në lëndë të tjera si statistikë, ekonometri, matematikë, ekonomiks, drejtim financiar, kontabilitet, etj. Gjithashu parimi themelor i ndërtimit të programeve të lëndëve është që pjesën më të madhe të përmbajtjes ta zënë njohuritë bazë dhe ato të thelluara. Në këtë aspekt GVJ është i mendimit se kryesisht ky program studimi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca bazë në fushën e tij të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2: Plani strategjik i IB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>



	<p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Në bazë të Planit Mësimor të paraqitur në Tabelat 9 dhe 10 të Aneksit, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi në UMSH paraqitet i strukturuar në përputhje me Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Elementët e programit të studimit janë në përputhje kryesisht me VKM nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar me VKM nr. 879 dt. 18.12.2019.</p> <p>Ai është i organizuar në pesë disiplina formuese sipas tipit të veprimtarisë nga A – E, përmbillet me 180 kredite dhe zgjat tre vite akademike. Vlerësimi i studentëve bazohet mbi parimin e vlerësimit të vazhduar në elementë të tillë si aktivizimi në seminare, detyra dhe projekte kursi, provim i ndërmjetëm dhe provim përfundimtar.</p> <p>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit paraqiten kryesisht në përputhje me aktet ligjore dhe konkretisht VKM nr.41 përsa i përket strukturimit të tyre.</p> <p><i>GVJ konstaton që në hartimin e Syllabuseve ka një mangësi në përcaktimin dhe shprehjen e qartë të njohurive, aftësive dhe kompetencave që studentët priten të përvetësojnë në përfundim të çdo lënde. Kjo mangësi u diskutua edhe gjatë vizitës në institucion si një çështje e karakterit teknik dhe jo thelbësor të përmbajtjes së programit dhe që pritet të përmirësohet më tej ndërkohë që edhe vetë formatet e syllabusëve janë në përmirësim të vazhdueshëm.</i></p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 9: Plani mësimor sipas tipit të veprimtarisë</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>



<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ konstatoi se ky program studimi i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese të grupuara sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite përkatësisht: Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, 5 module/lëndë (32 ECTS); - Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, 16 module/lëndë (95 ECTS); - Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 6 lëndë (25 ECTS); - Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 3 lëndë (21 ECTS); - Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (7 ECTS); <p>Kjo ndarje është në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, përsa i përket kategorizimit dhe krediteve përkatëse. <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 9: Plani mësimor sipas tipit të veprimtarisë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbylljes së standardit</p>	<p>Përmbylljet plotësisht</p>	<p>Përmbylljet pjesërisht</p>	<p>Përmbylljet kryesisht</p>	<p>Përmbylljet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi II.2</p>	
<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyll kërkimet ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyll detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, si njësi kryesore, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë. Sipas VBA Nr. 43, date 13.07.2018 UMSH është akredituar institucionalisht. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Biznesi është organizuar në përputhje me sistemin e Bolonjës, është licensuar sipas UMASH Nr. 225, datë 04.06.2013 dhe është akredituar sipas UMAS Nr. 283, datë 30.05.2016. Ky raport hartohet si pjesë e vlerësimit për akreditimin periodik të këtij programi.</p>




	<p>Duke u mbështetur tek dokumentat e sipërcituara si dhe të tjera të dorëzuara në dosjen e vetë vlerësimit (Rregullore e UMSH; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike; Rregullore e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor; Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi), GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar si dhe tek RVB, rezulton se njësia kryesore ka caktuar një person përgjegjës si Koordinator i Fakultetit, i cili është pjesë e personelit akademik. Koordinatorin ndihmon Dekanin për çështje të menaxhimit të fakultetit, nxit bashkëpunimin midis departamenteve dhe ndihmon në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me planin e punës së njësisë kryesore. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Nenin 19 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike. GVJ vëren se këto detyra janë të orientuara kryesisht drejt ecurisë dhe zhvillimit të programit dhe informimit të titullarit të njësisë kryesore, por nuk janë aq të qarta në lidhjet me studentët dhe kryerjen e praktikave profesionale. Për vetë rëndësinë që i përcakton ligji koordinatorit të programit si përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij,</p> <p><i>GVJ sugjeron që njësia kryesore të shpërndajë rolin dhe përgjegjësinë e koordinatorit të programit nëpër departamente, në mënyrë që të ketë më shumë persona të angazhuar në këtë rol, në mënyrë që edhe roli i tij të jetë më i qartë dhe më pranë studentit.</i></p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi është Fakulteti i Shkencave Ekonomike. Në zbatim të kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë ky fakultet organizohet në tre njësi bazë të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Financë Bankë Kontabilitetit; - Departamenti i Ekonomisë; - Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor;
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e</p>	

kualifikimit të personelit akademik.	FSHE në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij 69 pedagogë gjithsej , ndër të cilët, 52 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 17 staf akademik me kontratë, (PAK).																																																					
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, i cili gjithashtu në organizimin e tij plotëson detyrimet ligjore (duhet të ketë minimumi 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët të paktën 3 duhet të jenë me tituj/grada). Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="574 739 1375 1187"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2019-2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>12</td> <td>5</td> <td>13</td> <td>1</td> <td>9</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>18</td> <td>8</td> <td>20</td> <td>5</td> <td>17</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table> <p>Vlen për tu theksuar fakti që numri i personelit akademik ka një qëndrueshmëri ndër vite, si dhe ka një nivel të lartë akademik.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf</i> <i>Evidenca : Aneks 4. CV-te e stafit akademik.pdf</i></p>						Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	2	2	2	2	4	2	Prof. Asoc.	1	-	-	-	-	1	Dr./PhD.	3	1	5	2	4	-	Msc.	12	5	13	1	9	-	Totali	18	8	20	5	17	3
Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020																																																	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																
Prof.Dr.	2	2	2	2	4	2																																																
Prof. Asoc.	1	-	-	-	-	1																																																
Dr./PhD.	3	1	5	2	4	-																																																
Msc.	12	5	13	1	9	-																																																
Totali	18	8	20	5	17	3																																																
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X																																																	


<p>Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosjen e vetë vlerësimit, GVJ evidentoi se njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto informacione gjenden në dokumentat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike; - Rregullore e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor; - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi; - Plani Mësimor i Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi; <p>GVJ u informua gjithashtu në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion se të gjithë informacionin e nevojshme në lidhje me programin e studimit dhe lëndët i marrin nëpërmjet syllabuseve të lëndëve dhe materialeve që hidhen në portalin e studentit.</p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e UMSH, Kreu VI, Neni 43, 46” institucioni ka përcaktuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi rregullat e organizimit të programeve të studimit. Gjithashtu njësitet bazë kanë hartuar rregulloret përkatëse të programeve të studimit, të cilat janë në përputhje me këtë rregullore. Sipas Rregullores dhe Planit Mësimor të programit, programi realizohet me ndjekje të mësimin me kohë të plotë, kohëzgjatja e programit është në tre vite e ndarë në gjashtë semestra, në përfundim të të cilave studenti fiton 180 kredite ECTS. Sipas planit mësimor ky program është i organizuar në lëndë, module, praktika dhe aktivitetet formuese të cilat janë si më poshtë:</p> <p>Veprimtaritë formuese në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, 5 module/lëndë (32 ECTS); - Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore, 16 module/lëndë (95 ECTS);
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	



	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 6 lëndë (25 ECTS); - Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 3 lëndë (21 ECTS); - Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues, (7 ECTS); <p>GVJ konstaton se programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe evropian, të ndara në vite e semestra. Kreditet e një discipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese, kjo e përcaktuar në Rregulloren e Programit Bachelor në Informatikës Biznesi, si dhe në rregulloret e njësisë kryesore dhe rregulloren institucionit.</p> <p>GVJ në bazë të dokumentave të shqyrtura të përmendura më sipër, si dhe Planit Mësimor të Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi konstaton se në të gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Informacione të tjera të nevojshme në lidhje me këtë program studimi, të tilla si, frekuentimi/ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, etj., janë të paraqitura në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi Kreu IV dhe V, si dhe në Rregulloren e UMSH Kreu IX.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se UMSH ka përcaktuar kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve sipas legjislacionit në fuqi, duke i bërë ato të qarta dhe transparente për të gjithë studentët e interesuar. Përsa i përket pranimeve, kriterëve dhe dokumentacionit që nevojitet për regjistrim UMSH i ka të afishuara në faqen e web-it të institucionit, https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit në gjuhën shqipe dhe anglisht. Gjithashtu në faqe gjenden edhe kriteret për transferimet https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet.</p> <p>Gjithashtu kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit dhe regjistrimit në programet e studimit si dhe ato për transferimeve në UMSH gjenden edhe në dokumentat</p>



	<p>zyrtare, si: Rregullore e UMSH Neni 50, 68, 69; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike Neni 31, 44, 45; si dhe Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi Kreu III.</p> <p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi GVJ u informua që ata ishin të njohur me këto informacione që në fillim të njohjes me këtë institucion dhe me programin e studimit për të cilin ata kishin aplikuar.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit <i>Evidenca 48: Permbledhje e procedures se transferimit te studenteve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e shqyrtuara, GVJ konstaton se të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, të hartuar në përputhje me formatet e miratuara, gjenden qartësisht të shprehura në dokumentin “Aneks 1. Plani Mësimor”. Gjithashtu ky program studimi përmban Syllabuset e detajuara për secilën lëndë ku gjenden informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, etj, në përputhje me formatet e miratuara sipas VKM nr. 41 të ndryshuar. Syllabueset e lëndëve përmbajnë gjithashtu detyrimet për frekuentimin si dhe formën e kontrollit të dijeve që bazohet mbi vlerësimin e vazhduar që kryesisht mbështetet mbi këta komponentë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10% pjesëmarrje dhe aktivizim; - 20% detyra kursi / projekte; - 30% provim i ndërmjetëm; - 40% provimi përfundimtar; <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 9: Plani mësimor sipas tipit të veprimtarisë</i> <i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, GVJ u informua që përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave, që ka për qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, realizohet në zbatim të strategjisë së institucionit dhe akteve juridike të tij. Në bazë të Nenit 6 të Rregullores së NJSBCZHK, kjo njësi ndjek dhe kontrollon</p>




	<p>zbatimin e procedurave që zbatohen nga Dekanati dhe departamenti për ndryshimet në Syllabueset dhe programet e studimeve të miratura. Grupi ad-hoc për vlerësimin e brendshëm që ngre Dekani, ndër të tjera ka për detyrë edhe vlerësimin e shpërndarjes së krediteve, vlerësimin e programeve lëndore, dhe të elementëve përbërës të tyre.</p> <p>Gjatë takimit me pedagogët, GVJ u informua që procedurat për përmirësimin e programit zakonisht ndërmerren në fillim të çdo viti akademik dhe mund të vijnë edhe si iniciativë e pedagogëve të programit të studimit. Në Aneksin e RVB (Tabela 11) paraqiten ndryshimet që kanë ndodhur në përmbajtjen e programit të studimit për pesë lëndë.</p> <p><i>Evidenca 9: Rregullore NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 11: Ndryshimet në planin mësimor krahasuar me programet e licensuara</i> <i>Evidenca 16: Procedura per ndryshimin e kurrikules.pdf</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Sikurse e kemi cilësuar edhe në Standardin II.1 të këtij raporti, programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është i strukturuar në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, referuar Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, neni 73 pika 1.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni (Rregullore e UMSH, Neni 2 Baza Ligjore, Neni 43 Organizimi i Studimit; Kurrikula e Programit; Plani Mësimor, etj) ky është një program i ciklit të parë dhe si i tillë i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Modulet ose lëndët janë të shprehura në kredite përkatësisht 60 kredite në vitin e parë, 59 kredite në vitin e dytë dhe 61 kredite në vitin e tretë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin e parë zhvillohen 1550 orë, nga të cilat 660 orë në auditor dhe 890 orë jashtë auditorit;

	<ul style="list-style-type: none"> - Në vitin e dytë zhvillohen 1500 orë, nga të cilat 615 orë në auditor dhe 885 orë jashtë auditorit; - Në vitin e tretë zhvillohen 1375 orë, nga të cilat 590 orë në auditor dhe 785 orë jashtë auditorit; <p>Gjithsej ngarkesa e këtij programi është 4425 orë nga të cilat 1865 orë në auditor dhe 2560 orë jashtë auditori. Në përfundimin me sukses të studimeve studentët pajisen në total me 180 kredite ECTS dhe marrin diplomën Bachelor në “Informatikë Biznesi”.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf; Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është t’u japë studentëve njohuritë bazë formuese, duke u përqendruar tek formimi teorik dhe praktik i studentëve mbi teknologjinë e informacionit dhe implementimin në fushat e ekonomisë dhe biznesit. Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar (Plani Mësimor i programit të studimit, programet lëndore, baza e literaturës së detyrueshme dhe të sugjeruar për t’u përdorur, përgatitja akademike dhe kërkimore e stafit akademik) të cilat mbështesin përmbushjen e objektivave të programit, GVJ është i mendimit që kurrikula e programit të studimit në përgjithësi është një kurrikul që i përgjigjet qëllimit dhe objektivave të programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave i mundësojnë studentëve të këtij programi studimi rritjen e aftësive profesionale dhe punësimin e tyre. Kjo gjë mbështetet edhe në dokumentat e shqyrtuara.</p> <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi ofrohet në 3 vite mësimore, gjithsej 6 semestra me kohëzgjatje normale 15 javë në një semestër, dhe në përfundim të tij studentët marrin 180 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe sasia e krediteve është përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti i parë 11 lëndë (module dhe lëndë të veçanta) në total ka 60 kredite; - Viti i dytë 8 lëndë (module dhe lëndë të veçanta) në total 59 kredite;
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në</p>	




<p>kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Viti i tretë 9 lëndë (module dhe lëndë të veçanta) në total 61 kredite;
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se kjo shpërndarje bën të mundur arritjen e objektivave formues të këtij programi studimi dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe arsimit profesional (<i>Plani Mësimor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi</i>).</p> <p>Raportit teori/praktikë në këtë program studimi rezulton si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 905 orë leksione - 477 orë seminare - 343 orë ushtrime / laboratore - 20 orë projekte dhe detyra kursi - 120 orë praktika profesionale <p>Pra raporti teori/praktikë është 905 orë / 960 orë = 0.94.</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht peshën pothuaj të barabartë të orëve të praktikës ku përfshihen seminare, ushtrime, laboratore dhe praktika profesionale me orët teorike.</p> <p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat e aneksit në RVB si edhe Syllabus-et e disiplinave formuese të ofruara në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi në UMSH, konstaton se këto disiplina ofrojnë nivel të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. Emërtimi paraqet ngjashmëri me programe kombëtare dhe ndërkombëtare të kësaj disipline gjithashtu edhe përmbajtja e tij.</p> <p><i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë vizitës në institucion, në takim me përgjegjësin e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor, që në fillim të çdo viti akademik diskutohet me stafin akademik përgjegjës për këtë program studimi, në lidhje me përditësimin e syllabuseve të lëndëve, si dhe të literaturës në të cilat ato mbështeten. GVJ konstaton se kjo gjë realizohet realisht, edhe në përmbushje të kërkesave ligjore për të përdorur një literaturë të 5 viteve të fundit. Mbështetur tek syllabuset e lëndëve dhe literatura e deklaruar konstatohet se ka disa lëndë që literaturën e detyruar e bazojnë mbi libra të botuar edhe më herët se 5 vitet e fundit,</p>



	<p>por nga ana tjetër ato përdorin edhe leksionet e përgatitura nga vetë lektorët të cilat përditësohen për vit.</p> <p><i>Evidenca 16: Procedura per ndryshimin e kurrikules.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar tek shqyrtimi i Syllabuseve të lëndëve, duke analizuar përmbajtjen e tyre, GVJ konkludon se në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit, përsa i përket lëndëve që ofron, shpërndarjes së tyre sipas tipit të veprimtarisë (A-E), kombinimit të lëndëve që i përkasin fushës së informatikës nga njëra anë dhe asaj të ekonomisë nga ana tjetër, si edhe raportit teori/praktikë, mundëson plotësisht përfitim të dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teknike të synuara për një program të ciklit të parë. Duke shqyrtuar grupin e lëndëve karakterizuese të kategorisë B, të tilla si Algoritmikë, Arkitekturë dhe Vlerësim Kompjuterash, Sisteme Shfrytëzimi, Komunikim të Dhënash dhe Rrjetat, Teori e Bazave të të Dhënave, Programim në Web, Menaxhim, Marketing, Kontabilitet Financiar, etj, gjykojmë se përsa i përket aftësive teknike në profesion, syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi paraqiten gjithashtu të kompletuara.</p> <p>GVJ gjykon në bazë të numrit të krediteve, diplomës që përfitohet në përfundim të këtij cikli studimi si dhe në bazë të Syllabuseve të lëndëve të programit, se sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentave të dorëzuara dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion se Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor</p>

<p>më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>organizon periodikisht takime, workshop-e, leksione të hapura me ekspertë të fushës dhe lektorë të ftuar të cilët sjellin të rejtat e fundit të shkencës dhe prezantojnë kërkesat dhe tendencat e tregut të punës. Takimet shërbejnë jo vetëm për të shpërndarë njohuritë tek stafi i ri akademik dhe studentët, por edhe për të përmirësuar dhe përshtatur programin e studimit me kërkesat e tregut dhe ritmin e zhvillimit të teknologjisë. Kryesisht këto aktivitete zhvillohen në bashkëpunim me institucionet me të cilat UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Evidenca 39: Lista e aktiviteteve e organizuar nga DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 10: Lista e marreveshje te bashkepunimit te UMSH me institucione te tjera.pdf</i> <i>Evidenca 11: Memo mbi marreveshjet e bashkepunimit.pdf</i> <i>Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf</i> <i>Evidenca 8: Analiza e tregut.pdf</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="571 712 762 806">Përmbushet</th> <th data-bbox="762 712 962 806">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="962 712 1153 806">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1153 712 1375 806">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="571 806 762 855"></td> <td data-bbox="762 806 962 855"></td> <td data-bbox="962 806 1153 855"></td> <td data-bbox="1153 806 1375 855" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi II.5</p>	
<p>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentacionit të shyqrtuar se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Në Rregulloren e Organizimit të UMSH Kreu V, janë përcaktuar qartësisht politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik, cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe ndiqen me rigorozitet.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e programit mësimor, Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, përgjegjës për këtë program studimi ka angazhuar ndër vite, që nga viti 2016 – 2022, kryesisht personel akademik efektiv të vetin si dhe të departamenteve të tjera të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, kjo për vetë natyrën ndërdisiplinare të këtij programi studimi. Personeli akademik me kontratë i angazhuar në këtë program studimi është i spikatur, midis të cilëve janë emra të rëndësishëm të fushës së informatikës dhe teknologjisë së informacionit që mbajnë titullin Akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit</p>	



akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Për vitin akademik 2016 – 2017 kanë dhënë mësim 23 pedagogë nga të cilët 20 PAE dhe 3 PAK (87%/13%);
Për vitin akademik 2017 – 2018 kanë dhënë mësim 23 pedagogë nga të cilët 19 PAE dhe 4 PAK (83%/17%);
Për vitin akademik 2018 – 2019 kanë dhënë mësim 25 pedagogë nga të cilët 21 PAE dhe 4 PAK (84%/16%);
Për vitin akademik 2019 – 2020 kanë dhënë mësim 24 pedagogë nga të cilët 21 PAE dhe 3 PAK (87%/13%);
Për vitin akademik 2020 – 2021 kanë dhënë mësim 27 pedagogë nga të cilët 23 PAE dhe 4 PAK (85%/15%);
Për vitin akademik 2021 – 2022 kanë dhënë mësim 28 pedagogë nga të cilët 23 PAE dhe 5 PAK (82%/18%);

Numri total i personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, specifikisht për vitin akademik 2021 – 2022, është 28, nga të cilët 23 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 5 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK) nga ku:

Stafi akademik efektiv (PAE):

- 2 Prof. Dr;
- 3 Prof. Asoc. Dr;
- 9 Dr;
- 9 Msc;

Stafi akademik me kontratë (PAK):

- 2 pedagogë me titullin Prof. Dr;
- 2 Dr;
- 1 Msc;

Rezulton se përqindja e PAE është 82% ndaj atij PAK 18% në këto raporte qëndron edhe sasia e orëve të cilat i mbulon stafi PAE. Të gjithë kanë kualifikimin e nevojshëm dhe gradat shkencore sipas kërkesave të ligjit. (“Tabela 4. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Informatikë Biznesi 2021-2022”; “Tabela 6: Cilësia e stafit mësimdhënës të programit Bachelor në Informatikë Biznesi”).

Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa kontrata pune të pedagogëve efektivë dhe me kontratë. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse. GVJ e vlerëson këtë gjë si një nga pikat e forta të këtij programi studimi. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi ka një nivel të lartë kualifikimi në fushën akademike-kërkimore që është në përputhje me natyrën e këtij programi studimi.




	<i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 4, 6, 7</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Ashtu sikurse e kemi evidentuar në Standardin I.5 të këtij raporti, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe organizata të tjera biznesi dhe të administratës publike. Këto marrëveshje janë në funksion të përmirësimit të këtij programi studimi duke shkëmbyer eksperiencat e tyre më të mira, dhe duke ju mundësuar gjithashtu studentëve të këtij programi njohjen me tregun e punës, dhe me mundësitë e tyre të karrierës profesionale. Ndër to mund të përmendim Akademinë e Shkencave, INSTAT, Infosoft Group shpk, CODEIT, SmartWork shpk, Qendra Didaktike Irisoft, Deloitte Audit Abania, Application Management Development, CMD of ETS Tests, etj. Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se praktikat mësimore në këtë program studimi, shlyhen me orë në auditor, ku studentët realizojnë projekte mbi fushën e programimit web, bazës së të dhënave, rrjetave kompjuterike, etj. GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, i ka të gjitha kapacitetet akademike për realizimin dhe udhëheqjen e këtyre orëve të praktikave. <i>Evidenca 10: Lista e marreveshje te bashkepunimit te UMSH me institucione te tjera.pdf</i> <i>Evidenca 11: Memo mbi marreveshjet e bashkepunimit.pdf</i> <i>Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstaton se në dokumentat e dorëzuara në lidhje me personelin e angazhuar në këtë program studimi, nuk ka të parashikuar personel ndihmës akademik. Megjithatë në diskutimet që GVJ bëri gjatë vizitës në institucion me drejtuesin e departamentit, u informua se për mirëmbajtjen e laboratorëve angazhohet personeli administrativ, aktualisht zyra e TI.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik si dhe përgjegjës të departamentit, GVJ u informua që institucioni i jep një rëndësi të veçantë cilësisë së mësimdhënies, duke mundësuar vazhdimisht aktivitete trajnuese dhe kualifikuese në lidhje me metodat e ndryshme inovative të mësimdhënies. Sipas dokumentave të shqyrtuar dhe RVB, kontaktohet se gjatë vitit akademik 2020 – 2021 janë zhvilluar një sërë aktivitete në këtë kuadër, disa prej të cilave në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e procesit mësimor në auditor dhe online; - Përdorimin e sistemit SMS, elementët që kërkon çdo proces mësimor; - Udhëzues për procedurat dhe formatet e provimeve; - Udhëzues për procedurat dhe formatet e praktikave; - Udhëzues për procedurat dhe formatet e diplomave; <p><i>Evidenca 39: Lista e aktiviteteve e organizuar nga DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 35: Udhëzues i zhvillimit të mesimit online.pdf</i> <i>Evidenca 29: Manual i përdorimit të platformave online.pdf</i> <i>Evidenca 33: Udhëzues për përdorimin e SMS-se.pdf</i> <i>Evidenca 34: Udhëzues hartim teze.pdf</i> <i>Evidenca 39: Kalendari akademik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar (<i>Statuti i UMSH Neni 53 dhe 84, Rregullore e UMSH Neni 28</i>), GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura që janë përgjegjëse për vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK). Ajo në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit përdor mekanizmat e mëposhtëm për realizimin e detyrave të saj në procesin e monitorimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetsorin e vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues; - Pyetsorin e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti;
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin</p>	



dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

- Pyetësorët e vetëvlerësimit të pedagogëve;
- Ngritjen e fokus grupeve të monitorimit të procesit mësimor;
- Takimet e drejtuesve të njësive kryesore me studentët dhe këshillin studentor për diskutimin dhe adresimin e problematikave që lidhen me mësimin;


Kalendari i monitorimit të procesit mësimor dhe vlerësimit të performancës së stafit akademik planifikohet që në fillim të vitit akademik. Studentët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e performancës së pedagogëve si dhe të përmbajtjes së lëndëve, duke dhënë kështu një kontribut në përmirësimin e procesit mësimor në tërësi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ diskutoi me studentët në lidhje me përfshirjen e tyre në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies dhe konfirmoi se ata ishin vërtet pjesë e rregullt dhe e vazhdueshme e këtij procesi. Ata pohuan që kërkesat apo sugjerimet e tyre në lidhje me procesin e mësimdhënies apo dhe të vlerësimit në provime merreshin në konsideratë rast pas rasti në përputhje me Rregulloren e UMSH. Sipas kalendarit që harton NJSBCZHK, anketimi me studentët realizohet në përfundim të çdo semestri. Të dhënat e marra nga pyetësorët përpunohen dhe rezultatet ju vihen në dispozicion Dekanatit si dhe në mënyrë konfidenciale secilit pedagog. Raporti i vlerësimit semestral i paraqitet gjithashtu Rektorit nga NJSBCZHK. Ky raport ju vihet në dispozicion njësive bazë të cilat e analizojnë atë në mbledhjet e departamenteve.

Një rol të rëndësishëm në monitorimin e procesit mësimor ka edhe departamenti. Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor na informoi se së bashku me NJSBCZHK hartohet plani i punës për vlerësimin e performancës së pedagogut nëpërmjet monitorimit të mësimdhënies në auditor, nëpërmjet formularit të vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues, si dhe nëpërmjet takimeve me fokus grupet e studentëve.

Në bazë të Rregullores së NJSBCZHK Neni 9, raporti i vlerësimit semestral i dërgohet Rektorit brenda 30 ditëve, dhe pastaj i dërgohet drejtuesve të njësive kryesore dhe njësive bazë. Pas diskutimeve në Dekanat dhe në mbledhjet e departamenteve ato duhet të bëhen publike edhe për studentët, të cilët njihen me problematikat e ngritura dhe masat që do të merren për ti adresuar ato. Gjatë shqyrtimit të faqes së web-it apo dokumentave të depozituara, GVJ konstaton që nuk kemi një publikimin edhe në faqen e web-it të UMSH të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i

	<p>studentëve. Për të siguruar transparencë të plotë midis palëve të përfshira, <i>GVJ sugjeron publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit edhe në faqen e web-it, sigurisht duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p> <p>Bazuar tek diskutimi me Përgjegjësën e Departamentit si dhe tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konkludon se institucioni nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe raporteve që harton në bazë të tyre, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik. Në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimeve, diskutohen problematikat por edhe praktikat më të mira të evidentuara, duke i promovuar ato.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti.pdf</i> <i>Evidenca 9: Rregullore NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 21: Formular i vlerësimit te pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf</i> <i>Evidenca 22: Formular i Vlerësimit te pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf</i> <i>Evidenca 23: Plan monitorimi NJSCBZHK.pdf</i> <i>Evidenca 24: Procedura e punes me fokus grupet.pdf</i> <i>Evidenca 20: Raporti i Vetevlerësimit Individual.pdf</i> <i>Evidenca 13: Raporti vjetor i Institucionit.pdf</i> <i>Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf</i> https://www.umsh.edu.al/e/19/akte-ligjore</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton se forma e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve në UMSH është përcaktuar në Rregulloren e Organizimit të UMSH Neni 69, Rregulloren e FSHE Neni 35, Rregullore e DIFSH Neni 14, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Informatikës Biznesi Neni 16. Në përputhje me rregulloret e institucionit dhe përcaktimet ligjore është hartuar Plani Mësimor dhe Syllabusët e lëndëve. Bazuar tek këto të fundit GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive të miratuara dhe të përdorura në programin Bachelor në Informatikë Biznese janë: leksionet/ seminarët/</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit</p>	



dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.

laboratoret/ detyrat e grupit/ detyrat e kursit, seanca të praktikave profesionale, etj.

Sipas Planit Mësimor rezultojnë në auditor, përkatësisht sipas formave të mësimdhënies, në total orët e mëposhtëme:

- 905 orë leksione;
- 477 orë seminare
- 343 orë ushtrime / laboratore;
- 20 orë projekte dhe detyra kursi;
- 120 orë praktika profesionale;
- 1865 orë gjithsej në auditor;

Për vetë specifikën e këtij programi dhe natyrën e tij ndërdisiplinare me një ndërthurje midis fushës së informatikës dhe ekonomisë, programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat lidhen me përdorimin e kompjuterave dhe laboratorit me synim konkretizimin e anës praktike dhe përmirësimin e aftësive programuese dhe përpunuese të studentëve. GVJ u informua gjatë vizitës në institucion si edhe nga dokumentat e vëna në dispozicion, se institucioni i kushton një kujdes të veçantë respektimit të nevojave të studentëve me aftësi ndryshe duke krijuar korniza institucionale të përshtatshme për integrimin e tyre në procesin mësimor.

Sikurse e kemi përmendur edhe në standardin III.1 institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet seminareve, workshop-eve, trajnimeve të organizuara për këtë qëllim. Në këtë kuadër është hartuar një kalendar aktiviteteve "Program trajnimi dhe kualifikimi 2020-2021" nëpërmjet të cilit stafi akademik trajnohet në lidhje me fushat që kanë të bëjnë me aktet rregullatorë të institucionit, zhvillimin e procesit mësimor, hartimin e provimeve, të diplomave, ndjekjen e praktikës, përdorimin e sistemit elektronik SMS, etj. Gjithashtu stafi akademik nxitet të marrë pjesë në aktivitete shkencore si konferenca dhe botime artikujsh në revista shkencore, në mënyrë që rritja e tyre në aspektin shkencor të ecë paralelisht me atë didaktike.

Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf

Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf

Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf

Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf

Evidenca: Aneks 1. Plani Mesimor.pdf

Evidenca 19: Program trajnimi dhe kualifikimi.pdf

Evidenca 39: Lista e aktiviteteve e organizuar nga DIFSH.pdf

Evidenca 35: Udhezues i zhvillimit te mesimit online.pdf

Evidenca 29: Manual i perdorimit te platformave online.pdf

	<p><i>Evidenca 33: Udhezues per perdorimin e SMS-se.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 34: Udhezues hartim teze.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ vlerëson si një nga pikat e forta të këtij programi studimi cilësinë e stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie. UMSH ka angazhuar një personel akademik shumë të kualifikuar, me tituj e grada shkencore duke filluar nga akademikë të njohur të fushës së informatikës, pedagogë me eksperiencë profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare, fusha e studimit të cilëve është në përputhje me lëndët që ata zhvillojnë, duke qenë në përmbushje të kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Këtë gjë e mbështesin edhe CV e personelit akademik si dhe të dhënat e paraqitura në “Tabela 7: Të dhëna përmbledhëse të stafit akademik sipas kualifikimit”.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që ata janë gjithmonë në kërkim të përmirësimit të vazhduar didaktik dhe akademik, duke përdorur mjete bashkëkohore për mësimdhënien sipas tematikave të lëndëve të tyre.</p> <p>Në bazë të “Tabela 7: Të dhëna përmbledhëse të stafit akademik sipas kualifikimit” jepen në detaje numri i titujve dhe gradave të personelit akademik gjatë periudhës 2016-2022. Gjatë kohës së shkrimit të këtij raporti, viti akademik 2021 – 2022 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi janë angazhuar 28 pedagogë, titujt dhe gradat e të cilëve janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 pedagog me titullin Prof. Dr; - 3 pedagog me titullin Prof.Asoc; - 11 pedagog me gradën Dr.; - 10 pedagogë me Master Shkencor; <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 7</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 4. CV-te e stafit akademik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në takimin që u zhvillua me stafin akademik dhe studentët, GVJ u informua se gjatë procesit mësimor përdoren metoda të ndryshme didaktike në mënyrë që ai të jetë sa më interesant dhe afër studentit. Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi ka avantazhin që kërkon përfshirjen e teknologjisë së informacionit në zhvillimin e leksioneve, seminareve apo laboratorëve. Kjo e bën më tërheqëse dhe konkrete, dhe si rrjedhim dhe më të kuptueshme për studentin temën që është duke u shpjeguar. Nga ana tjetër për lëndët e disiplinave të tjera, pedagogët përdorin pajisjet e teknologjisë për të bërë prezantime apo shfaqur rezultate të kërkimeve në internet. Gjithashtu pedagogët pohuan se përdorin metodat e fokusuara tek diskutimet në grupe, duke i nxitur studentët të përfshihen të gjithë në seminare.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e</p>	

autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësime dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Në takimin me përgjegjës të departamentit, GVJ u informua që një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vazhduar të procesit mësimor luajnë studentët, me kërkesat apo sugjerimet e tyre për procesin mësimor, nëpërmjet anketimeve periodike semestrale që zhvillohen me ta, nëpërmjet diskutimeve në fokus grupet që ngrihen të planifikuara në këtë proces, si dhe nga vetë diskutimet që pedagogët bëjnë në klasë në kontaktin e drejtpërdrejtë me studentët. Çështjet e ngritura prej tyre janë adresuar në raportet periodike që harton NJSBCZHK në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe në raportet vjetore të institucionit.

Ashtu sikurse është përmendur edhe më herët në këtë raport, pedagogët janë të përfshirë në trajnime dhe kualifikime si brenda vendit dhe jashtë. Pjesëmarrja e tyre në programet e shkëmbimit të stafit akademik nëpërmjet bursave Erasmus+ ka kontribuar në përmirësimin e metodave të mësimit. GVJ u informua se një nga prioritetet e institucionit është ndërkombëtarizimi, duke hartuar një Strategji Ndërkombëtarizimi e cila synon unifikimin e proceseve akademike të UMSH me partnerët ndërkombëtarë.

Midis formave të mësimit që zhvillohen në këtë program studimi janë edhe zhvillimi i detyrave dhe të projekteve të kursit individuale ose në grup. Nëpërmjet tyre synohet të nxitet studentin të punojë i pavarur, duke nxitur të menduarin kritik të tyre, si dhe duke i bërë ata më të hapur dhe të aftë të artikulojnë lirish opinionet e tyre. Gjatë prezantimit të projekteve të grupeve studentët promovohen që të fitojnë aftësi shprehëse dhe argumentuese edhe në debatin mes njëri - tjetrit.

Evidenca 23: Plan monitorimi NJSBCZHK.pdf

Evidenca 24: Procedura e punës me fokus grupet.pdf

Evidenca 20: Raporti i Vetevlerësimit Individual.pdf

Evidenca 13: Raporti vjetor i Institucionit.pdf


Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në	

<p>hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ vizitoi të gjitha ambientet që lidhen me zhvillimin e procesit mësimor të programit të studimit Bachelor në Informtikës Biznesi, ku përfshihen klasat e leksioneve, të seminareve dhe laboratorët e kompjuterëve. U vizituan gjithashtu mjediset e përbashkëta si biblioteka, zyrat e stafit akademik dhe administrativ, mjediset e pushimit dhe çlodhjes, etj. Bazuar tek vëzhdimi mjedisëve dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton se veprimtaria akademike e UMSH realizohet në mjedisë moderne, me hapësira të bollshme dhe të pajisura me mjete të teknologjisë së fundit të informacionit. Përkatësisht këto hapësira përbëhen nga 2 objekte me sipërfaqe totale 3860 m² në të cilat disponohen:</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>- 6 salla leksioni; - 17 salla seminaresh; - 2 laboratore lëndësh; - 3 laboratore informatike; - 1 sallë interneti; - 17 zyra; - 4 salla biblioteke; - 430 m² hapësira pushimi;</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>UMSH plotëson kërkesat ligjore për normën e sipërfaqes dhe vëllimin shfrytëzues për student, përmbush kërkesat për ngrohjen, ftohjen, kushtet higjeno-sanitare, etj. Mjediset ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me shërbim interneti wifi, projektorë, CCTV, sistem zëri-fonie, mjete audio-vizive, mundësohet zhvillimi i video-konferencave në to, etj. Në pajisjet kompjuterike janë të instaluar programe të përgjithshme të përdorimit si dhe programe specifike në përmbushje të kërkesave të lëndëve të ndryshme të tilla si: Windows 7, paketa Microsoft Office, Python, MySQL, R Studio, Financa 5, Alfa Business, EXCELLER, T-Translator, GINGER. Të gjitha mjediset që kanë kompjutera dhe mjete të teknologjisë së informacionit mirëmbahen nga Zyra e TI. <i>Evidenca 18: Relacion i verifikimit te godines 2022.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 16</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në lidhje me literaturën bazë dhe ndihmëse që pedagogët ju vendosin në dispozicion studentëve, GVJ konstaton se së pari studentët marrin slidet e leksioneve apo leksionet e përgatitura nga pedagogët të cilat janë në gjuhën shqipe. Duke ju referuar syllabuesëve të lëndëve, GVJ konstaton se lëndët referojnë një literaturë të bollshme dhe bashkëkohore me tekste mësimore të autorëve të njohur dhe ekspertëve të fushës vendas dhe ndërkombëtarë, por ka disa raste ku kjo literaturë i përket botimeve të më shumë se 5 viteve më parë.</p>

	<p>Në diskutimin që u bë me stafin akademik dhe përgjegjës të departamentit në lidhje me plotësimin e kërkesave ligjore për përdorimin e literaturës së 5 viteve të fundit, <i>GVJ ju sugjeroi përditësimin e literaturës së referuar.</i></p> <p>Gjatë takimit GVJ u informua se stafi akademik i përditësonte materialet e leksioneve dhe prezantimet me literaturë aktuale, pavarësisht literaturës së referuar. GVJ konkludon se literatura e detyruar dhe e rekomanduar dhe materialet që ju vihen në dispozicion studentëve mbështesin marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve të programit, Viti i parë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve të programit, Viti i dytë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve të programit, Viti i tretë.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në bibliotekën e UMSH konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një hapësirë kryesore të vetme për bibliotekën me rreth 30 poste pune nga të cilat 8 poste me kompjutera. Kjo sallë është në dispozicion të të gjithë studentëve të UMSH dhe mund të konsiderohet jo e mjaftueshme për kapacitetin e studentëve të të gjitha programeve të studimit në UMSH. Nga ana tjetër konstatohet që disa nga titujt e literaturës së detyruar për këtë program studimi mungojnë fizikisht në bibliotekë. GVJ mendon se ka vend për shtimin e titujve të librave në literaturën fizike sidomos në gjuhën shqipe, për të mbështetur nevojat e programit Bachelor në Informatikë Biznesi. Gjithashtu është e nevojshme që të përditësohet literatura e bibliotekës me botime të viteve të fundit. Gjatë diskutimit me punonjësit e bibliotekës për adresimin e kësaj çështje, GVJ u informua se institucioni ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, jo vetëm fizike por duke ju sjellë studentëve dhe pedagogëve edhe mundësitë e aksesit në bibliotekat online.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se UMSH është bërë anëtare e COBISS me të drejta të plota që nga fillimi i vitit 2022. Gjithashtu UMSH është pjesë e Electronic Information for Libraries, që i mundëson përdorimin e bibliotekës elektronike nëpërmjet platformës Elgar Publishing. UMSH ka abonim vjetor në bibliotekën online Questia, ku ka mundësi aksesit deri në 327.000 tituj librash. Fondi i librave të të gjitha bibliotekave online në të cilat UMSH ka akses është në dispozicion të personelit dhe studentëve pa kufizim.</p>



	<p><i>Evidenca 30: Tutorial mbi perdorimin e bibliotekes online.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 31: Marreveshja COBISS.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 32: Marreveshja ELGAR Publishing.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Sikurse e kemi cilësuar edhe në kriteret më sipër UMSH vë në dispozicion të studentëve 3 laboratorë informatike dhe 1 sallë interneti. Laboratorët janë të pajisur me programe kompjuterike në përputhje me specifikat e programit. Studentët i shfrytëzojnë në mënyrë të vazhdueshme laboratorët në fuksion të procesit mësimor, në përgatitjen e detyrave të kursit, apo për praktikimin e njohurive të marra në leksione dhe seminare. Megjithatë GVJ sugjeron shtimin e laboratorëve kompjuterikë, për vetë faktin se UMSH ofron shumë programe studimi që kanë në kurrikulën e tyre lëndën e informatikës, përveç këtij programi që shumicën e lëndëve duhet ti zhvillojë në laborator.</p> <p>Përsa i përket platformave online, GVJ konstaton se UMSH përdor me sukses që prej vitit 2020 platformat online G-suite, Google Classroom, Zoom Webinnar. Gjithashtu institucioni përdor sistemin e komunikimit të brendshëm SMS (Student Management System). Studentët që në momentin e regjistrimit pajisen me kredencialet e tyre për të aksesuar sistemin. Edhe stafi akademik ka llogaritë e veta në këtë sistem. Në këtë mënyrë shkëmbimi i informacionit që lidhet me të gjitha aspektet e procesit mësimor bëhet nëpërmjet kësaj platforme. Sistemi i menaxhimit të studentëve ju ofron akses të dedikuar të gjithë pjesëmarrësve: pedagogëve, studentëve, sekretarisë.</p> <p><i>Evidenca 33: Udhezues per perdorimin e SMS-se.pdf</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdheta</p> <p>£</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Sipas vendimit të institucionit, në përputhje me Rregulloren e Organizimit të UMSH Neni 72, Rregulloren e FSHE Neni 51, Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi Neni 23, për përmushjen e detyrimeve përmbyllëse në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi diplomimi i studentëve bëhet me provim formimi. Studentët asistohen nga pedagogët e këtij programi studimi për mënyrën e zhvillimit dhe përmbajtjen e provimit të formimit. Gjithashtu atyre ju vihet në dispozicion edhe “Programi orientues për provimin e formimit Bachelor” nga Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p>

	<i>Evidenca 44: Program orientues per provim formimi.pdf</i> <i>Evidenca 45: Udhezues per provim formimi.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar se në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, UMSH ka ngritur Njësinë e Brendëshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, si njësinë kryesore në nivel institucional në kuadër të sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë. Kjo njësi emërohet dhe varet nga Rektori i UMSH. Ajo vlerëson dhe raporton periodikisht pranë Rektorit dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të institucionit në aspektin e përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë (Statuti i UMSH Neni 84. Rregullore e Organizimit të UMSH Neni 28). NJSBCZHK në funksion të ushtrimit të kompetencave të saj bashkëpunon me njësitë kryesore duke ngritur grupe pune të cilat verifikojnë veprimtarinë mësimore, mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p><i>Evidenca 1: Statuti.pdf</i> <i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 9: Rregullore NJSBCZHK.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sikurse e përmendëm edhe në kriterin 1 të këtij standardi, NJSBCZHK bashkëpunon me njësitë kryesore për të ngritur grupet ad-hoc të punës, ku një anëtar vjen nga departamenti, të cilat ngrihen në funksion të vlerësimit periodik të programeve të studimit dhe rregulloreve të tij.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor janë njësi kryesore dhe bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Në takim me Përgjegjës të Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor, GVJ u informua për rolin e rëndësishëm të Dekanit dhe Përgjegjës të Departamentit në promovimin dhe rritjen e cilësisë në mësimdhënie në këtë program studimi. U theksua se Përgjegjësi i Departamentit një nga funksionet që ushtron, ka</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të</p>	

<p>vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>edhe mbikëqyrjen e procesit të mësimdhënies. Ai në bashkëpunim me NJSBCZHK organizojnë kontrole periodike për mënyrën e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve në auditor. Gjithashtu një nga mekanizmat që përdoren në departament për vlerësimin e mësimdhënies është edhe “Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues”.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Përsa i përket zhvillimit të metodave të reja të mësimin, GVJ u informua se në këtë program studimi për vetë natyrën e tij të lidhur me teknologjinë e informacionit, mësimi bëhet në laborator, ku përveç leksioneve dhe seminareve, studentët kryejnë simulime duke marrë raste konkrete të zgjidhjes së detyrave në fushën e TI. Gjithashtu pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare ka sjellë një frymë të re në realizimin e procesit mësimor, sidomos shkëmbimet e stafit akademik me bursat Erasmus+.</p> <p>Për rritjen e nivelit akademik të stafit, departamenti inkurajon pedagogët për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, konferenca, workshop-e, etj. Institucioni mbështet gjithashtu pjesëmarrjen e personelit akademik në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. Gjithashtu në fillim të vitit akademik, departamenti planifikon një sërë aktivitete trajnuese për stafin akademik të cilat kontribuojnë në përmirësimin e procesit mësimor në tërësi.</p> <p><i>Evidenca 9: Rregullore NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 23: Plan monitorimi NJSCBZHK.pdf</i> <i>Evidenca 24: Procedura e punes me fokus grupet.pdf</i> <i>Evidenca 20: Raporti i Vetevleresimit Individual.pdf</i> <i>Evidenca 19: Program trajnimi dhe kualifikimi.pdf</i> <i>Evidenca 21: Formular i vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf</i> <i>Evidenca 22: Formular i Vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf</i> <i>Evidenca 43: Strategjia e nderkombetarizimit.pdf</i> <i>Evidenca 39: Lista e aktiviteteve e organizuar nga DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 12: Marreveshje e Erasmus me universitetin Lasapienza.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe</p>	<p>Në bazë të Rregullores për Organizimin e UMSH (<i>Neni 40-42 “Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe administrativ”</i>), personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Përgjegjësitë e stafit akademik dhe ndihmës akademik janë gjithashtu të</p>


implementimin e metodave të reja.	përcaktuara në kontratën e punës dhe në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Neni 25. Në takimin me stafin akademik. GVJ konstatoi se ata i njohin përgjegjësitë e tyre në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe janë të angazhuar vazhdimisht për përmirësimin e tij. Një faktor i rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjes së stafit akademik dhe angazhimit të tij në këtë proces përmirësimi, luajnë edhe vlerësimet periodike të performancës së stafit, të përmenduar në kriteret e mësipërme. GVJ u informua që raportet e nxjerra adresojnë problematikat por vlerësojnë edhe praktikat më të mira në kuadër të mësimdhënies dhe metodave të përdorura. Ato diskutohen në mbledhjet e departamentit midis kolegëve. <i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 14: Raporti vjetor i DIFSH 2021-2022.pdf</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren e UMSH Neni 61-66, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike Neni 37-42, Rregullore e DIFSH Neni 18-25. Këto dokumenta janë në dispozicion të studentëve sipas kërkesës së tyre.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjithashtu studentët njihen me mënyrat e vlerësimit dhe testimit nëpërmjet prezantimit të lëndës dhe të Syllabus-eve në javën e parë të semestrit nga pedagogët e tyre. Syllabuset dhe materialet e tjera në lidhje me mësimin ata i kanë të disponueshme edhe në portalin e tyre http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_M esdhetar.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Referuar Rregullores së Programit Bachelor në Informatikë Biznesi dhe Syllabuseve, rezulton se në Syllabus janë parashikuar format e vlerësimit dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Testimi i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet nëpërmjet provimeve përfundimtare, provimeve të ndërmjetme, detyrave të shtëpisë, detyrave të kursit, ushtrimeve dhe punëve të laboratorit, etj. Të gjitha këto aktivitetet janë të parashikuara në Syllabus-et e lëndëve.


	<p>Testimet mund të zhvillohen me shkrim, me gojë apo me kompjuter, në varësi të specifikave të lëndëve. Në këtë mënyrë studentëve ju jepet mundësia të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë vitit.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i> <i>Evidenca 58: Udhezues mbi prodeurat dhe afatet e sezonit te provimeve.pdf</i> <i>Evidenca 45: Udhezues per provim formimi.pdf</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar <i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Bazuar tek syllabuset e lëndëve si dhe tek informacioni i dhënë në Aneksin 3 - Tabela 15: "Forma e kontrollit të njohurive sipas %", GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës mësimore dhe është rezultante e disa elementëve të tilla si: vlerësimi i pjesëmarrjes, i detyrave të kursit, i provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar. Pesha që zë secili aktivitet në vlerësimin e vazhduar është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10% • Plotësimi i detyrimeve (lab/detyra kursi) 20% • Testim i ndërmjetëm 30% • Provimi përfundimtar 40% • Totali 100% <p>Duke pasur mundësi që studenti të kontrollohet gjatë gjithë vitit për ecurinë e tij dhe dijet e fituara, është më e lehtë të</p>

	<p>evidentohen boshllëqet dhe paqartësitë, dhe të rikuperohen ato në mënyrë që rezultati përfundimtar të jetë sa më i kënaqshëm për ta.</p> <p><i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 15</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik se përsa i përket provimeve të ndërmjetme dhe finale që zhvillohen në lëndë të ndryshme, në përgjithësi ato zhvillohen kryesisht me shkrim dhe metoda e korigjimit është ajo standarde, ku korigjimin e bën pedagogu. Ka lëndë specifike ku provimi mund të kërkojë ekzekutimin e programeve kompjuterike të cilat vlerësohen në kompjuter. Por në lidhje me përdorimin e sistemeve elektronike të testimimit dhe korigjimit, GVJ nuk gjen ndonjë evidencë në përdorimin e tyre. Megjithatë GVJ u informua që institucioni gjatë periudhës së pandemisë ka përdorur testimet online me Google Forms ose Microsoft Teams, të cilat sipas rastit i përdorin edhe aktualisht.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar (<i>Udhëzues për hartimin e tezës</i>) GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Nëse lëndën e jep vetëm një pedagog, përgjegjësi i departamentit cakton një pedagog tjetër në komision mundësisht nga gruplënda. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës para zhvillimit të provimit, firmoset nga përgjegjësi i grup-lëndës ose përgjegjësi i njësisë bazë. Në takimin me pedagogët e këtij programi studimi, GVJ u informua se kjo praktikë ndiqet me rigozitet. <i>Evidenca34: Udhezues hartim teze.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, ata pohuan se provimet zhvillohen të sekretuara. Kontrolli i mjeteve të identifikimit në klasë bëhet nga sekretaria mësimore, gjithashtu edhe procesi i sekretimit të fletoreve. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për të verifikuar statusin e studentit nëse i ka përmbushur të gjitha detyrimet dhe lejohet të zhvillojë provimin. Provimi monitorohet nga pedagogët e lëndës ose të tjerë që janë caktuar nga përgjegjësi i departamentit. Gjatë monitorimit pedagogët shmangin tentativat për kopjim, rastet të cilat bien ndesh me Rregulloren e institucionit. Studentët marrin rezultatet e</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse</p>	




<p>është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>vlerësimit brenda 3 ditëve nëpërmjet sistemit SMS. Këto rregulla janë të përcaktuara edhe në dokumentin “Udhëzues për hartim teze”.</p> <p>Në bazë të udhëzimeve në dokumentin e sipërcituar, Pika 6 “Vlerësimi i provimit”, si dhe të informacionit që dhanë studentët në diskutimet me ta, GVJ konstaton se në korigjimin e tezave të provimit, pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha boshllëqet apo pyetjet e realizuara duke dhënë komentet përkatëse që mbështesin vlerësimin total. Korigjimi bëhet sipas tabelës që ndodhet në fund të tezës në të cilën ndodhen edhe komentet.</p> <p>Në bazë të dokumentit “Udhëzues për hartim teze: Pika 3- Mënyrat e ndërtimit të tezës” teza e provimit është ndërtuar e tillë duke pasur në konsideratë nivele të ndryshme njohurish nga ato më të thjeshtat deri tek më të vështirat duke i dhënë mundësi studentëve të të gjitha niveleve të arrijnë rezultatin në përputhje me angazhimin e tyre. Në të përmbahen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përshkruese të cilat synojnë të testojnë dijet e fituara të studentëve; - Pyetje shpjeguese të cilat nxjerrin në pah logjikën e studentit për përshkrimin e fenomeneve dhe lidhjen shkak-pasojë; - Pyetje vlerësuese që nxjerrin në pah një logjikë të caktuar të studentit në përdorimin e dijes së përvetësuar; <p>Sikurse e përmendëm edhe më sipër tezat korigjohen brenda tre ditësh nga data e provimit, studentët marrin rezultatet nëpërmjet sistemit SMS dhe ju jepet mundësia e ankimit të rezultatit të provimit brenda dy ditëve, sipas rregullave që përcakton Rregullorja e Organizimit të UMSH dhe Rregullorja FSHE. Çdo kërkesë shqyrtohet nga komisioni fillestar i provimit. Nëse komisioni gjykon se ka vend për ndryshime, ja komunikon notën studentit dhe e hedh atë në sistem. Nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim dhe ta dorzojë në sekretarinë mësimore, në këtë rast ngrihet një komision tjetër me miratimin e Dekanit. Komisioni i ri është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë. E gjithë procedura dokumentohet në departament. Në përfundim të procesit, teza së bashku me zgjidhjen depozitohet në departament gjithashtu. Provimet me shkrim të studentëve ruhen nga pedagogu i modulit për 1 vit pas përfundimit të sezonit të provimeve.</p> <p><i>Evidenca 34: Udhëzues hartim teze.pdf</i> <i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	




	<i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i> <i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është në përputhje me kornizën Shqiptare të kualifikimit niveli Nr. 6 përse i përket njohurive që ofron nëpërmjet leksioneve, seminareve dhe praktikave profesionale. Gjatë 3 viteve akademike zhvillohen 27 lëndë/module, për të cilat metoda e përcimit dhe kontrollit të dijeve është nëpërmjet leksioneve, seminareve, laboratorëve, detyrave të kursit, projekteve.</p> <p>Në bazë të Syllabuseve të lëndëve GVJ gjykon se gjatë zhvillimit të mësimin në këtë program përdoren metoda të cilat janë në funksion të thellimit të njohurive për studentët. Njohuritë bazë që merren gjatë leksioneve aplikohen në seminare dhe laboratorë ku studentët zhvillojnë edhe aftësi profesionale. Në bazë të Nenit 4 të Rregullores së Programit, objektivi kryesor është formimi teorik dhe praktik i studentëve mbi teknologjinë e informacionit dhe implementimin në fushat e ekonomisë dhe biznesit. Niveli i njohurive të fituara është i tillë që i lejon studentët të vazhdojnë ciklin e dytë të studimit ose studime të tjera të specializuara. Në bazë të Planit Mësimor (<i>Aneks 3: Tabela 9</i>) në kategoritë e lëndëve që përbëjnë gjithë programin ka lëndë të tilla që sigurojnë një zhvillim të aftësive të veçanta të studentëve, përtej boshtit kryesor të këtij programi që është informatika e aplikuar në biznes. Mund të përmendim Sociologjinë, Shkrimin Akademik, Njohuritë mbi Trashëgiminë Kulturore, Çështjet Ligjore të Informatikës.</p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 3. Tabelat.pdf-Tabela 9</i> <i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i></p>




	<i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Sikurse është evidentuar në kriteret e mësipërme të këtij raporti, vlerësimi i përmbajtjes së lëndëve bëhet së pari nëpërmjet anketimeve të studentëve. Raportet që dalin nga këto anketime shërbejnë për analizimin dhe përmirësimin e njohurive, kompetencave dhe aftësive që ofron lënda. Në takimin me përgjegjësën e departamentit dhe pedagogët, GVJ u informua që Syllabuset e lëndëve gjithashtu diskutohen në fillim të çdo viti akademik, me qëllim përmirësimin e tyre në aspektin e përmbajtjes dhe të metodologjisë, dhe për të sjellë zhvillimet e fundit në fushën përkatëse. Të gjitha ndryshimet e propozuara dërgohen në Dekanat për miratim. GVJ ka evidentuar edhe në standardin II.1 të këtij raporti që për disa nga lëndët, paraqitja e njohurive, aftësive dhe kompetencave që studentët priten të përjetësojnë në përfundim të çdo lënde duhet të jetë më e qartë dhe e përcaktuar. Në takimin me pedagogët dhe studentët GVJ konfirmoi faktin që në përfundim të çdo lënde në fund të semestrit, pedagogu bën përmbledhje të gjithë çështjeve kryesore dhe orienton studentët për tu përgatitur për provimin përfundimtar. Gjithashtu gjatë sezonit të provimeve studentët kanë mundësi të konsultohen me pedagogët e tyre për paqartësitë që mund të kenë.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	<i>Evidenca: Aneks 2.1 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i pare.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.2. Syllabuset e lendeve te programit, Viti i dyte.pdf</i> <i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i>
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor gjatë vitit akademik 2021 – 2022 ka zhvilluar një sërë aktivitete në kuadër të prezantimit të të reja të shkencës dhe teknologjisë. Ndër to mund të përmendim leksione të hapura, webinar-e, trajnime, tryeza diskutimi, etj. (Lista e aktiviteteve të organizuara nga DIFSH). Të gjitha aktivitetet e kryera janë të publikuara edhe në faqen e web-it të institucionit. <i>Evidenca 39: Lista e aktiviteteve e organizuar nga DIFSH.pdf</i> https://www.unsh.edu.al/e/141/aktivitete-2022
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Për vetë faktin se ky program studimi ka një natyrë ndërdisiplinare, si dhe ka si shtyllë kryesore teknologjinë e informacionit, GVJ konstaton se pothuaj të gjitha lëndët kanë mundësi të testojnë kompetencat e marra të studentëve në laborator gjatë zhvillimit të mësimin. Mësimi i përshtatet natyrës së lëndës dhe ofron zhvillim kompetencash nëpërmjet

<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>projekteve të studentëve. Gjithashtu plani mësimor ka parashikuar Praktikën si lëndë më vete, e cila zhvillohet në semestrin e fundit të vitit të tretë të studimeve. Kjo lëndë ka si objektiv ti japë studentit aftësitë e duhura që teorinë e mësuar gjatë studimeve ti vendosë në praktikë.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Sikurse e kemi përmendur edhe tek metodat e mësimdhënies, gjatë zhvillimit të mësimin përdoren diskutimet në klasë dhe detyrat në grup apo edhe projektet e përbashkëta të kursit. Kjo gjë u konfirmua edhe nga studentët në takimin me ta. Gjatë diskutimeve studentët përfshihen në situata hipotetike të biznesit apo në diskutime të studimeve të rastit, dhe diskutojnë për zgjidhjet e tyre.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Pedagogët motivojnë studentët gjatë orëve të mësimin në mënyrë që ata të ndjehen komodë gjatë diskutimeve, dhe të japin sa më shumë nga idetë e tyre të cilat i finalizojnë në detyrat e kursit. Gjithashtu ata janë të inkurajuar që të shkojnë përtej thjesht diskutimeve në klasë duke i paraqitur idetë e tyre inovative në organizime më shkencore si konferenca, konkurse apo aktivitetet të tjera. Tabela 22 në Aneks 3 tregon për aktivizimin e studentëve në punime shkencore së bashku me pedagogët e tyre, si dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore në rang fakulteti. Një tjetër risi për studentët në tre vitet e fundit ka qenë Panairi i Ideve ku ata prezantojnë idetë e tyre në formën e punimeve në seanca “brainstorming”. Këto aktivitete ndiqen nga Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Gjithashtu rritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit ka mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Mund të përmendim një nga marrëveshjet e suksesshme të UMSH, marrëveshjen Erasmus me Universitetin La Sapienza.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p><i>Evidenca: Aneks 2.3 Syllabuset e lendeve te programit, Viti i trete.pdf</i> <i>Evidenca 43: Strategjia e nderkombetarizimit.pdf</i> <i>Evidenca 12: Marreveshje e Erasmus me universitetin Lasapienza.pdf</i> <i>Evidenca 11: Memo mbi marreveshjet e bashkepunimit.pdf</i> <i>Evidenca 10: Lista e marreveshje te bashkepunimit te UMSH me institucione te tjera.pdf</i> <i>Evidenca 41: Rregullore ZKSK.pdf</i> https://www.umsh.edu.al/d/372/organizohet-konferenca-shkencore-perfshirja-e-te-rinje-ne-nje-dialog-konstruktiv-e-kaluar-komuniste-ne-ballkanin-perendimor-bashkekohor https://www.umsh.edu.al/d/330/erasmus-niset-grupi-i-pare-i-studenteve-te-umsh-ge-do-te-studiojne-nje-semester-jashte-vendit</p>



	https://www.umsh.edu.al/d/214/punairi-i-ideve-studentet-prezantojne-iniciativat			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyllet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Sikurse e kemi evidentuar edhe në Standardin III.3 të këtij raporti, në përfundim të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, për përmushjen e detyrimeve përmbyllëse, diplomimi i studentëve bëhet me provim formimi. Kjo është e përcaktuar në Rregulloren e Organizimit të UMSH Neni 72, Rregulloren e FSHE Neni 51, Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi Neni 23.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Institucioni ka përgatitur udhëzuesit “Programi orientues për provimin e formimit Bachelor” dhe “Udhëzues për provim formimi” të cilat jua vë në dispozicion studentëve që në fillim të vitit të tretë. Këta udhëzues janë të publikuar edhe në faqen e web-it të institucionit. Literatura në lidhje me përgatitjen për këtë provim së bashku me udhëzuesit depozitohen në bibliotekë.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ konstaton se studentët gjithashtu asistohen nga pedagogët për tu përgatitur për këtë provim, në lidhje me strukturën e tezës, lëndët ku do të përqendrohet provimit, literaturën që do të përdorin, ku do të gjejnë materialet, etj. Gjatë sezonit të diplomimit, si në atë të verës edhe atë të vjeshtës, departamenti shpall edhe oraret e konsultimeve sipas grup-lëndëve që përbëjnë strukturën e provimit.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Provimi i formimit është gjithëpërfshirës, dhe mbulon tema të fushave kryesore të programit të studimit të zhvilluara gjatë tre viteve. Ai përfshin pyetje që lidhen me: <ul style="list-style-type: none"> - Pjesën e formimit të përgjithshëm e cila vlerësohet me 40 pikë në total: Menaxhim, Marketing, Kontabilitet, Statistikë; - Pjesën e profilit e cila vlerësohet me 60 pikë në total: Programim, Teori e Bazave të të Dhënave, Komunikim të Dhënash dhe Rrjetat Kompjuterike, Algoritmikë dhe Strukturë të Dhënash; <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i></p>



	<p><i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 44: Program orientues per provim formimi.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 45: Udhzues per provim formimi.pdf</i></p> <p>https://www.umsh.edu.al/media/5ee210c8c94d4.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi këto kritere nuk janë të aplikueshme, meqënëse në bazë të Rregullores ata e mbrojnë diplomën me provim formimi.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 6: Rregullore DIFSH.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 8: Rregullore e programit bachelor ne Informatike Biznesi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas “Udhëzuesit për Provimin e Formimit” provimet e formimit korrigjohen nga komisioni ditën e provimit. Të gjithë pedagogët korrigjojnë pyetjet sipas grup lëndëve. Kryetari i komisionit të provimit të formimit me ndihmën e Koordinatorit të Fakultetit hedh pikët në listën e studentëve pas ç’sekretimit të provimeve, dhe i hedh në sistemin SMS brenda 48 orëve. Notat ju dërgohen studentëve nga Koordinatorja e Fakultetit në bashkëpunim me sekretarinë. Nota e Provimit të Formimit nuk ankimohet sepse është vendim kolegjal i komisionit të provimit.</p> <p>GVJ konstaton se në Rregulloren e Organizimit të UMSH Neni 74, Rregulloren e FSHE Neni 53 përcaktohet që pas përfundimit me notë kaluese në Provimin e Formimit studenti pajiset me diplomën e nivelit përkatës dhe suplementin e diplomës. Për këtë program studimi, në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomën Bachelor në “Informatikë Biznesi”. Në përfundim të studimeve nëse studentët dëshirojnë të tërheqin edhe një kopje zyrtare të firmosur dhe vulosur të programit të studimit, mund të depozitojnë një kërkesë në sekretarinë mësimore, e cila brenda një afati të caktuar ju jep kopjen e kërkuar.</p> <p>Në takimin me zyrën e Sekretarisë Mësimore, GVJ u informua që kjo zyrë është përgjegjëse për hapjen e dosjes personale (fizike dhe elektronike) të studentit që në momentin e</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	


	<p>regjistrimit të tij. Pas diplomimit të studentit kjo dosje arkivohet sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit nr. 9154 “Për arkivat në RSH”. Një kopje e saj mund ti vihet në dispozicion studentit në bazë të kërkesës së tij, duke ndjekur procedurat që përcakton Rregullorja e Organizimit të UMSH.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore organizimi UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4: Rregullore FSHE.pdf</i> <i>Evidenca 44: Program orientues per provim formimi.pdf</i> <i>Evidenca 45: Udhezues per provim formimi.pdf</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	<p>GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetë vlerësimit (DVV) ku specifikohet se informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ruhen në dy nivele. Të dhënat në lidhje me stafin akademik fillimisht mblidhen dhe depozitohen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor). Në nivelin e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimit, mblidhen dhe administrohen nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila administron dosjet e plota për çdo anëtar të personelit. Gjatë vizitës në zyrën e MBNJ nuk u evidentuan mangësi në mos ruajtjen e dokumentacionit (diploma apo ekuivalente) në origjinal apo të noterizuar në dosjet respektive të të dhënave të personelit akademik.</p> <p><i>(Evidenca 5 “Rregullore e Organizimit të UMSH”, neni 37.</i> <i>Evidenca 4 “Rregullore e Programit të Studimit”, nenet 10 & 11.)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që u bënë pjesë e DVV si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin

<p>rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Këto procedura paraqiten në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kërkohet staf akademik me gradën shkencore Doktor, pra një nivel më lart se niveli i studimeve, Master i Shkencave. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme sic u verifikua nga tabelat e të dhënave në RVB. Bazuar në RVB, procesi i seleksionimit të kandidatëve kalon në disa faza, procesi kryhet në mënyre transparente dhe aplikantët njoftohen në secilën fazë, deri në pranimin në punë të kandidatëve të përzgjedhur. Gjatë vizitës në zyrën e MBNJ u kërkua verifikimi për 2 rekrutimet më të fundit (PAE) të na vendosej në dispozicion dokumentacioni që ka shoqëruar gjithë këtë proces, por u konstatua se në dosjet respektive nuk ishin ruajtur dokumentat e kërkuara.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH", nenet 54 – 59. Evidenca 28 "Përmbledhje e Procedurës së Rekrutimit të Stafit". Evidenca "https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-Universitetit-mesdhetar-i-shqiperise")</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteretë posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit për disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit.</p> <p>GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik pa grade shkencore nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ këshillon IAL se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e përbashkët të rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master do të ishin shumë të rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH", neni 57; Evidenca 5 "Rregullore e Organizimit të UMSH", neni 38 & 39; Evidenca 8. "Rregullore e programit Bsc ne Informatike Biznesi")</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteretë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në</p>	<p>Sipas GVB procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një Kërkesë për Rekrutim Staf akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kriteretë që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteretë i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen</p>




<p>përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>te rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në web faqen e Institucionit por sipas tyre edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit. (Evidenca 1 "Statuti i UMSH", nenet 54 – 59. Evidenca 28 "Përmbledhje e Procedurës së Rekrutimit të Stafit".)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi në vend kushtet e punës dhe mjedisin që i mundësonte personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ kryerjen e detyrave të tyre përkatëse. Mjediset e Institucionit gjenden në një vendndodhje të mirë në qytetin e Tiranës, lehtësisht të aksesueshme. Zyrat ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme dhe të gjitha ambientet e Institucionit mbuloheshin nga rrjeti wireless që ofronte Internet për stafin dhe studentët. (Evidenca 8. Rregullore e DIFSH;)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se në dokumentat bazë (Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH, Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi), përmenden synime dhe objektiva të mirëfillta të Institucionit për përmirësimin e stafit akademik. Sipas RVB dhe evidencave (tabelat 19 dhe 20) mund të konstatojmë se kërkimi shkencor i stafit, si edhe marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura mes Institucionit dhe partnerëve të rëndësishëm akademikë dhe të biznesit, tregojnë se UMSH aktualisht është në drejtimin e duhur për aktivitete kërkimore dhe bashkëpunime shkencore. Gjithashtu, nga intervistat me përgjegjësin e departamentit, zv.Rektorin dhe</p>



	<p>stafin akademik, GVJ u informua se përparësi në financim kanë personat që mbrojnë doktoraturën, dhe si lehtësim mund të kenë reduktim oresh, ose edhe financime për pjesëmarrje në konferenca shkencore. Kërkohet kujdes nga GVB në vendosjen e disa referencave të cilat nuk ishin relevante për këtë kriter.</p> <p><i>(Evidenca 6 "Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH". Referenca nga Tabelat e RVB: Tabela 27 "Raporti i punes shkencore". Tabela 31 dhe 32 "Marreveshjet Cobbis dhe Elgar".</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, si dhe gjatë takimeve me pedagogët dhe Përgjegjësin e DIFSH GVJ konstatoi se Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe së fundmi edhe në kuadrin e përdorimit të teknologjive të reja të mësimdhënies. Bien në sy trajnime për përdorimin e platformës së mësimi online G Suite dhe sistemet "Student Management System". Plani i trajnimeve për stafin akademik hartohet në fillim të vitit akademik dhe të pyetur mbi nivelin e zbatueshmërisë së tij, stafi u shpreh se ishin trajnuar nga Institucioni. <i>(Evidenca 19 "Programi i Trajnimeve 2020-2021". Evidenca 35 "Udhëzues mbi përdorimin e platformave të mësimi online")</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV <i>(Tabelat 1 dhe 2 në evidencën 18: "Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit")</i> si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se DIFSH, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Për vitin akademik 2020 – 2021, Fakulteti Shkencave Ekonomike ka 54 PAE dhe 13 PAK. Ky program studimi ka te angazhuar ka 25 personel akademik efektiv, dhe 5 personel akademik me kontratë. Për vitin akademik 2021 – 2022, Fakulteti Shkencave Ekonomike ka 52 PAE dhe 17 PAK, Ky program studimi ka te angazhuar ka 25 personel akademik efektiv, dhe 5 personel akademik me kontratë dhëna më të detajuara për numrin dhe kualifikimet e personelit akademik janë dhënë më herët në këtë raport Standardi II.2). Sipas GVB, ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj tek PAE dhe PAK dëshmon për një angazhim të personelit akademik për plotësimin e objektivave të programit të studimit. <i>(Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu V, Neni 38 -39 Aneksi 4).</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se UMSH e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimi si bibliotekë, sallë interneti, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV (<i>Evidenca 18, Relacioni mbi verifikimin e godines</i>), GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, 1 sallë interneti, 1 sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përvec ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj. <i>Tabela 16. "Mjediset e fakultetit dhe njesia baze"</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV (tabela 16), GVJ konstatoi se ambientet mësimore në UMSH ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike. (<i>Tabela 16 dhe tabela 17 "Mjediset e fakultetit dhe njesia baze".</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe</p>	<p>Në funksion të programit të studimit Bsc Ne Informatike Biznesi ka në dispozicion laboratorë informatike (Tabela 16). Ata janë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale si: Alpha dhe Financa 5, SPSS apo programi i Business English, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë</p>

<p>mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit, pavarësisht se studentët u shprehën që nuk kishin kohë të shkonin aty për të punuar. <i>Aneks 3 (Tabela 16 dhe 17)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni listohen disa mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera aplikative praktike në bashkëpunim me institucione të tjera. Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, në <i>evidencën 19</i>, GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale janë hartuar me qëllim që studentët përveç anës teorike të mësojnë dhe anën praktike. Po kështu, gjatë vizitës në Institucion, studentët konfirmuan angazhimin e UMSH për praktikat e tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p><i>(Aneks 4 "Përmbledhëse e Tabelave për programin"; Tabela 5)</i> https://www.umsh.edu.al/d/317/bashkepuniimi-20-studente-te-rinj-te-universitetit-mesdhetar-punesim-6-muaj-ne-banke:</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të</p>	<p>Sipas verifikimeve të dokumentacionit (<i>tabela 16 në RVB</i>) të kryera nga GVJ, Institucioni raporton se disponon salla për biblioteka. Këto salla, sic u konstatua në vend, në fakt ishin ambiente të përshtatshme për lexim e studim, por bibliotekë e mirëfilltë ishte vetëm një hapësirë kryesore e vetme, rreth</p>




<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>30 poste pune në total, 8 poste me kompjutera, dhe orari i funksionimit ishte 8.30 – 20.00. Kjo sallë është në dispozicion të të gjithë studentëve të Institucionit dhe mund të konsiderohet shumë e vogël për kapacitetin e studentëve që ndjekin studimet në UMSH</p> <p><i>(Evidenca 18 “Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit”. Tabela 16; Evidenca 29. Informacion mbi Infrastrukturën e UMSH”)</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në Bibliotekat e Institucionit mund të gjenden fizikisht gjithsej 4.440 tituj librash në rreth 26.424 kopje gjithsej. Tekstet në bibliotekë janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, kryesisht atë angleze. Meqënëse në DVV nuk u gjetën dokumentacione bazë në lidhje me përmbajtjen e titujve në bibliotekë, gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi në vend, tituj në bibliotekë të cilët janë të pakët dhe, <u>GVJ sugjeron shtimin dhe zgjerimin e tyre, pavarësisht se për këtë program studimi mund të përdoren libra dhe literaturë online e cila gjendet me bollëk edhe në UMSH me mbi 327.000 tituj librash në format elektronik.</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në bibliotekën online Questia, ku Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka abonim vjetor, ka mundësi aksesit deri në 327.000 tituj librash. Ky fond librash, bashke me ato që ofron Edward Elgar Publishing, Cobiss.al dhe Springer books, janë në dispozicion të personelit dhe studentëve të UMSH pa pagese, në funksion të punës mësimore dhe shkencore sipas fushave të interesit. Gjithashtu në RVB Institucioni deklaroi se ka dixhitalizuar rreth 17.000 tituj tekstesh mësimore nga fushat e programeve të studimit që ofrohen. Përsëri në DVV nuk gjendet informacion më i detajuar në lidhje me këtë proces</p> <p><i>(Evidenca 31 dhe 32 http://biblioteka.umsh.edu.al/; https://www.e-elgar.com/; https://al.cobiss.net/)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në sallat e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesit në Internet nëpërmjet rrjetit wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të UMSH. Por nga ana tjetër në bibliotekë kishte vetëm 30 poste kompjuterike nga të cilat vetëm 8 me kompjutera. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë.</p> <p><u>Sugjerohet shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve dhe të stafit akademik.</u></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni, për këtë kriter deklarohet se UMSH angazhohet në nxitjen e njërive kryesore dhe njërive bazë që cdo vit të paraqesin kërkesat e tyre për tituj të rinj në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që secila prej tyre ofron. Një pjesë e tujve të rinj të shtuar së fundmi në bibliotekë janë edhe botime të personelit akademik të Institucionit.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Salla e Bibliotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Biblioteka kishte 8 poste pune me kompjuter, dhe 30 poste pune në total. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në periudha normale ishin nga ora 8.30 – 20.00. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përputhje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u vu në dijeni nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në DVV se UMSH ka në përdorim dhe shfrytëzon një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacioneve në lidhje me gjeneralitetet dhe ecurinë e studentëve. Sistemi SMS – Student Management System mundëson koordinimin e punës mes stafit akademik dhe atij mbështetës nga njëra anë dhe studentëve nga ana tjetër. Sistemi ofrohet në gjuhën shqipe dhe sic referohet në RVB është funksional duke filluar që nga dhjetori 2017. Sistemi ka akses të dedikuar dhe të vecantë për stafin akademik dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit. Sic u informuam gjatë vizitës në Institucion, ky sistem kishte përdorim të gjerë nga ana e stafit dhe studentëve dhe atyre u ofroheshin trajnime përgatitore për përdorimin e sistemit. Sistemi SMS përdorej gjerësisht edhe nga ana e stafit administrativ. Të dhënat mund të përditësohen elektronikisht, përveçse mbahen në hard-</p>



	<p>copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Ndërsa, të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar) dhe të gjitha regjistrat në formë të shkruar dhe në version elektronik, janë në administrimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>(Evidenca 33 "Manual përdorimi i SMS për pedagogët". Evidenca 29 "Udhëzues mbi përdorimin e platformave online". http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, SMS është një sistem i cili mundëson administrimin e të dhënave për studentët dhe jo për aktivitetet e personelit akademik.</p> <p>Në RVB për këtë kriter nuk u gjendën të dhëna të dobishme dhe as referenca që mund të shfrytëzoheshin nga GVJ. Dokumentacioni apo aktivitetet e personelit akademik, ndihmës akademik apo partnerëve menaxhohen nga Zyra e BNJ e cila ka një sistem informacioni manual.</p> <p><i>GVJ sugjeron që zgjerimi i sistemit aktual SMS ose implementimi i një sistemi tjetër për menaxhimin e të dhënave për personelin do ishte e nevojshme për përmbushjen e këtij kriteri.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse referohet në RVB të përgatitur nga Institucioni dhe sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, nga ana e GVJ, sistemi SMS ofron akses të dedikuar në dokumentacionet e nevojshme duke pasur dy panele aksesit: paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës dhe paneli i dedikuar për studentët.</p> <p>Nëpërmjet sistemit SMS, stafi akademik mund të realizojë shumë funksione të ofruara nga modulet e ndryshme të sistemit, si psh., modifikojë të dhënat personale në modulën „profili im“, të kontrollojë klasat mësimore, të realizojë hedhjen e notave dhe të kontrollojë kërkesat për rishikim, të kontrollojë planet mësimore për cdo lëndë, etj. <i>(Evidenca 29 "Manual përdorimi i SMS për pedagogët")</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas të dhënave të referuara në RVB, sistemi SMS i UMSH, mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave personale të emailit. Më shumë informacion në lidhje me sistemin, GVJ mori gjatë vizitës në Institucion. Gjithashtu, u konstatua se për të menaxhuar në mënyrë sa më efektive procesin mësimor online, gjatë vitit akademik 2020-2021 Institucioni implementoi edhe platformën G Suite me komponentët Google Classroom dhe Google Meet.</p>

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të studentëve në UMSH, është një sistem që mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mësimin nga ana e studentëve dhe e stafit. Kjo referohet në RVB të përgatitur nga institucioni por konstatohet edhe në evidencën “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”. Megjithatë, sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion sistemi nuk mundësonte gjenerimin e raporteve individuale dhe të dhëna në kohë reale përtej atyre që kanë të bëjnë me mësimdhënien. (Evidenca 29 “Manual përdorimi i SMS për pedagogët”).</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it të universitetit (sipas disa referencave në links më poshtë). GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për shumë prej tyre mungon një bio e shkurtër prezantuese.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorzuar në DVV, UMSH përcakton në Statutin pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare (Evidenca 1, “Statuti i UMSH”, nenet, 24, 45).</p> <p>Sipas statutit buxheti hartohet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar, Planin Strategjik të Institucionit dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Bordi i Administrimit të UMSH dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore.</p> <p>Evidencë për informacione financiare të lidhura me të ardhurat dhe kostot gjendet në DVV si pjesë e të dhënave financiare institucionale (evidenca 17), dhe në tabelën 18 në evidencën 8.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të</p>	

<p>procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH". Evidenca 2" Rregullore e Organizimit të UMSH"; Tabela 18 "Të ardhurat dhe financimi..." në Aneksin 4 "Përmbledhëse e Tabelave të RVB". Evidenca 22 "Analizë vjetore e FSHE")</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Përgjigja për këtë kriter në RVB ishte teorik, nuk ka evidencë dhe mungon raporti auditimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Për të analizuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ u mbështet në analizën e RVB dhe tabelave mbështetëse të saj, si edhe dokumentacionit shoqërues, pjesë e DVV.</p> <p>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni, kontrolli buxhetor realizohet nga Administratori dhe synon të garantojë përdorimin eficient të burimeve të Universitetit, në funksion të arritjes së objektivave të tij. Sipas DVV, detyrë e Administratorit është pikërisht ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të çdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare.</p> <p>Në vijim të analizës së shkallës së përmbushjes së këtij kriteri, nga shqyrtimi i tabelës 18 në evidencën 8, GVJ konfirmon se Institucioni ka paraqitur një plan financiar institucional të krahasuar buxhet kundrejt faktit që nga viti akademik 2018-2029.</p> <p>(Evidenca 1 "Statuti i UMSH". Evidenca 2" Rregullore e Organizimit të UMSH". Tabela 18, Evidenca 8 "Përmbledhëse e Tabelave të RVB". Evidenca "Analizë vjetore e FSHE").</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të</p>	<p>Në bazë të informacioneve financiare të dhëna në tabelën 18, GVJ konstaton se Institucioni rezulton me fitim. Megjithatë nuk jepen informacione më të plota që të lejojnë GVJ të</p>

programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	formojë një opinion të plotë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të Institucionit. <i>(Tabela 18, Evidenca 8 "Përmbledhëse e Tabelave të RVB". Evidenca "Analizë vjetore e FSHE")</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të RVB (evidencat 3, 4 dhe 5), u konstatua se Institucioni ka hartuar politika dhe procedura të plota të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e nevojshme të ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre në hyrje dhe në dalje, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin e tyre në përfundim të ciklit të studimeve. Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me këkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MASR. <i>(Referenca nga DVV"; Evidenca 5 "Rregullore e organizimit të UMSH". Evidenca 8 "Rregullore e programit të studimit Bsc ne Informatike Biznesi"; https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjës in e Departamentit dhe GVB, GVJ u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi i propozohet nga Departamenti. Kandidatët që dëshirojnë të frekuentojnë kete programin e studimit "Bsc ne Informatike Biznesi" duhet të plotësojnë kriteret e renditura në nenin 12 të dokumentit "Mbi pranimet e studentëve", të cilat lidhen me përfundimin e matures shteterore

	<i>Referenca nga DVV”; Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X Evidenca 5 “Rregullore e organizimit të UMSH”. Evidenca 8 “Rregullore e programit të studimit Bsc ne Informatike Biznesi”</i>		
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit të paraqitur, GVJ formoi bindjen se kriteret e pranimit, të përzgjedhjes dhe ecurisë së studentëve përgjatë programit të studimit janë transparente, pjesë e dokumentacionit zyrtar të Institucionit (si Statuti i UMSH apo Rregullorja e Programit të Studimit), dhe për më tepër janë publikuar edhe faqen e internetit të Institucionit. <i>(Referenca nga DVV: Evidenca 1 “Statuti i UMSH”. Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike”. Evidenca 8 “Rregullore e programit të studimit Bsc ne Informatike Biznesi”</i>		
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, referohet se Institucioni harton dhe bën publike para çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe referon për këtë procedurën e parashikuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike (neni 32, pika 2). Kriteret e pranimit për programin rishikohen çdo vit nga departamenti në bashkëpunim me FSHE dhe janë në përputhje të plotë me LALKSH 80/2015 dhe me rregulloren e FSHE dhe të programit të studimit. <i>(Referenca nga DVV: Evidenca 3 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike” Neni 32, pika 2; Evidenca 8. “Rregullore e programit të studimit Bsc ne Informatike Biznesi”)</i>		
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konfirmon se UMSH publikon një sërë udhëzimesh në faqen e internetit të institucionit që lidhen me rregullore dhe procedura të pranimit në programet e studimit. Vec kësaj, nga bisedat me përfaqësues të Zyrës e Këshillimit të Studentit dhe Karrierës, u pranua se bëhej një punë e konsiderueshme për informimin e të interesuarve. (https://www.umsh.edu.al/c/46/udhezime)		
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e UMSH. Rregulloret u vihen në dispozicion studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjësin e departamentit në bashkëpunim me strukturat e tjera organizative të UMSH kur organizojnë javën e parë për çdo viti akademik ku kryhet edhe prezantimi i programit, rregulloreve, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve. Gjithashtu, nëpërmjet sekretarisë mësimore, ata informohen për orarin mësimor, frekuentimin, datat e provimeve, të cilat gjenden edhe në faqen online të UMSH si edhe tek shërbimi informacionit në hyrje të UMSH.</p> <p><i>(Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu III.</i> <i>Neni 14-26; Evidenca 8. "Rregullore e programit të studimit Bsc ne Informatike Biznesi"; https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të UMSH në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hock i Ekuivalentimit. Të gjitha këto ju bëhen me dije studentëve paraprakisht.</p> <p><i>(Evidenca 9. "Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike", Kreu VIII, Neni 44-45; https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme Evidenca "Udhezuesi i Studentit")</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në syllabull të cdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimin, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë çdo fillim semestri, ditën e parë të javës së parë.</p> <p><i>(E Aneks 2.1: 2.2;2.3 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2021-2022;Neni 21-23 dhe Kreu VI, Neni 24; Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu VIII, Neni 35-43; Evidenca 8. Rregullore e DIFSH, Kreu III, Neni 18-26.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit, dhe të programit</p>

punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	përkatës të studimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi provimin e formimit. <i>Evidenca 45 "Udhëzim për provim formimi"</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UMSH në fillim të çdo viti akademik organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto informacione përcillen edhe përmes panairove apo masmedias, si edhe përgatitjes së fletëpalosjes dhe posterave për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij. Gjithashtu, UMSH ka vendos shumë rol që studentët potencialë mund t'a marrin informacionin për programin e studimit pranë sekretarisë mësimore. Studentët informohen për të gjitha detajet e programit të studimit edhe përmes broshurës së studimeve master. (https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres <i>Evidenca 14. Broshura e studimeve Master</i>)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	N	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit, në llogarinë individuale të Studentëve në SMS si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqet në faqen e internetit të UMSH, ku kurrikula ngelet për t'u përditësuar.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës, por edhe një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambjentet e institucionit. https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres; https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike; https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si	Referuar RVB, UMSH mbështet veprimtari në funksion të punësimit si pjesëmarrje në panairove, organizime takimesh me profesionistë të secilit profil, etj. Institucioni informon si




dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH-s, rrjeteve sociale, leksioneve të hapura, takimeve dhe informimeve të kryera nga ZKSK. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione publike dhe biznese, si edhe zhvillimin e aktiviteteve me institucione shtetërore, kompani private dhe me zyrat e punës që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve. (https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e FSHE, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e UMSH lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. DIFSH mbështetet edhe nga njësitë e tjera ndihmëse si Sekreteria Mësimore, Biblioteka, ZKSK, etj https://www.umsh.edu.al/c/103/fakulteti-i-shkencave-ekonomike ; https://www.umsh.edu.al/c/174/njoftime)			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	UMSH kujdeset për Menaxhimin e Sistemit të Informacionit “SMS” i cili synon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH, studentët mund të komunikojnë në distancë me pedagogët, ose të shikojnë të dhënat që ata kanë hedhur në këtë sistem. Gjatë vizitës në IAL dhe intervistave me stafin akademik por edhe GVB na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin elektronik me studentët. (http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.	UMSH mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të FSHE. (Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika	Sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë,


<p>vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për cdo vit akademik. Referuar dok (Tabela 21 Cilesia e studenteve ne hyrje dhe dalje) numri i studentëve të regjistruar në tre vite akademike është:</p> <p>2019-2020; 43 student regjistruar (93 të transferuar) – 136 gjithsej; 2020-2021; 65 student regjistruar (66 të transferuar) - 131 gjithsej; 2021-2022; 92 student regjistruar (74 të transferuar) – 166 gjithsej;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna mbahen dhe përditësohen elektronikisht dhe në hard copy në rregjistrat e notave dhe të diplomave të Sekretarisë Mësimore. Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar). Gjatë vizitës në Sekretari Mësimore u kërkuan të verifikohen rregjistrat e studentëve të transferuar në hyrje apo në dalje, si edhe studentët e padiplomuar përsa kohë mund të jenë ende të regjistruar përtej kufirit të kohës së lejuar (dyfishi i kohës së studimit që do të thotë 6 vjet akademik).</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ verifikoi me përzgjedhje disa të dhënat të studentëve të programit të studimit MSCAB, të cila përfshinin të dhënat personale, numrin e matrikullimit, vlerësimet, etj. Këto të dhëna sipas Kryesekretares menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit pranë Sekretarisë Mësimore. Të gjitha këto të dhëna gjenden dhe menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nën kujdesin dhe përgjegjësinë e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>(http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Evidenca 36 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"; Evidenca 33. Udhëzues i përdorimit të sistemit SMS)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të</p>	<p>GVJ konstaton nga tabela 21 në evidencën 18 "Përmbledhëse e Tabelave"se, IAL ka përpunuar disa të dhëna analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje por jo në dalje të studentëve, si edhe nëse është i punësuar apo jo. Evidentojmë se kaq nuk është e mjaftueshme për t'u konsideruar një raport mbi profilin e studentëve dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, dhe për më tepër që aty mungojnë masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p><u>GVJ rekomandon që Zyra e Karrierës të shkëputet nga varësia e NJSBC dhe të dalë si zyrë më vete me qëllim ndjekjen efektive të</u></p>

përmirësimin të këtyre treguesve.	<p><i>ecurisë së ALUMNI dhe tërheqjen e mendimeve të tyre në mënyrë të vazhdueshme.</i></p> <p><i>(Tabela 21 dhe 23 në Evidencën 18. "Përmbledhëse e Tabelave për programin MSCAB")</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" si dhe neni 81, pika c, të Statutit të UMSH institucioni duhet të angazhojë studentë dhe/ose përfaqësues të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të UMSH. Sipas RVB-së, studentët në UMSH janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X, Neni 83; Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu VIII, Neni 58; Evidenca "Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor".)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Nga GVB nuk evidentohet qartë garantimi dhe përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi nga GVB të shprehin si plotësohet ky kriter në UMSH dhe në çfarë strukturash ka përfaqësim nga studentët? GVB konfirmoi se një përfaqësues i studentëve ishte i përfshirë në këtë RVB, studentët janë në klubin e studentëve, në këshillin e studentëve ku gjenden senatorët e çdo viti dhe programi, etj. Por, studentët e pyetur për këtë kriter nuk kishin informacion se kush prej tyre është pjesë e strukturave vendimmarrëse apo vlerësuese të procesit akademik.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X, Neni 83; Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu VIII, Neni 58; Evidenca 40. Rregullore e ZKSK; https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor)</i></p>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi është i mirë hartuar në drejtim të mbajtjes në konsideratë të ngarkesës akademike të</p>



<p>studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>studentëve dhe ndarjes sipas Veprimtarive Formuese nga A në E në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu, referuar statutit të UMSH dhe rregulloreve përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme në përputhje me kriteret ligjore në RSH. (Evidenca 8. "Rregullore e Programit të studimit").</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në UMSH aplikohen disa metoda për përfshirjen me qëllim tërheqjen e mendimit të studentëve lidhur me procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Përmes formularëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve; ● Mbledhjet e hapura të Departamentit dhe Këshillit Studentor; ● Përmes studentit si përfaqësues në Senat; ● Përmes studentit si përfaqësues në NJSBC; ● Përmes fokus grupeve; <p>GVJ kërkoi nga NJSBCZHK disa raste konkrete të ilustruara për çfarë është marrë në konsideratë mendimi i studentëve të këtij programi Studimi. Pergjigja nga drejtuese e NJSBCZHK ishte se nga Studentët nuk ka pasur asnjë pretendim apo sugjerim për përmirësime. (Evidenca 21. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës)</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në disa evidence të paraqitura nga GVB pretendohet se studentëve të këtij programi ju mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë si edhe e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve. Evidencat janë statuti i UMSH dhe kuadri rregullator. Lidhur me rezultatet e provimeve, mbas çdo provimi brenda dy ditëve që është koha e korrigjimit të provimeve, studentët informohen për rezultatet dhe nëse ka pakënaqësi ata kanë të drejtë konsultimi me pedagogët respektivë dhe pastaj nëse nuk bien dakort bëhet ankimimi pranë DIFSH. (Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf. (Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Kreu VIII, Neni 42; Evidenca 8. Rregullore e programit të studimit, Kreu III, Neni 23; Evidenca "Udhëzim për provimin e ndërmjetem, perfundimtar dhe të sezonit përsëritës").</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Referuar RVB-së, në përputhje me Udhëzimi nr.27, Dt.29.12. 2017: Pika 6 Shkr b, Pika 13, të Ministrisë së Arsimit, UMSH, duke u bazuar edhe në Statutin dhe rregulloren e saj, më qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve, ka ngritur strukturën e karrierës e quajtur Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK). Përsëri, nëse do ti referoheshim GVB, konstatojmë se sipas narrativës së tyre për këtë standard, ZKK mban kontakte të vazhdueshme me studentët e programit “Bsc Ne Informatike Biznesi” në ecurinë e karrierës së tyre profesionale edhe mbas përfundimit të studimeve si edhe i referohet Tabelës 23 “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve”</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL konstatoi se nuk është e qartë nëse ka një zyrë me staf të dedikuar vetëm për këto detyra apo krahas disa pozicionesh punësh të tjera ju duhet të kryejnë edhe këto detyra të cilat në fakt janë shumë të rëndësishme jo vetëm pse janë detyrim nga kuadri ligjor e rregullator. Por, gjithashtu, u konstatua se për udhëzimet e studentëve kujdesej edhe Koordinator i programit të studimit, Departamenti, Sekretaria Mesimore, etj.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu VI, Neni 53; Evidenca 4. Rregullore e UMSH, Kreu IV, Neni 36; Evidenca 30. Rregullore ZKSK; Tabela 23 “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve”)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe	

organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përkrahje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe komunikimit me drejtues të IAL gjatë vizitës në IAL, konstatohet se UMSH në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 ka ngritur strukturën e NJSBC dhe Zhvillimit të Karrierës referuar Nenit 53 dhe 84 të Statutit të UMSH dhe nenit 28 të Rregullores së Përgjithshme që nga Janari 2011 në strukturën organizative të institucionit. Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me NJSBCZHK.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Referuar Nenit 52 të Statutit të UMSH dhe Nenit 22 të Rregullores së Përgjithshme mund të ketë të ngritur edhe Komisionin e Përhershëm në funksion të sigurimit të cilësisë, <i>GVJ rekomandon që IAL për shkak të madhësisë që ka si institucion, ku veçse për këtë program studimi janë me disa qindra të rregjistruar, duhet të krijojë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në nivel Institucioni me anëtar nga pretendentët kryesorë, me mandate të qarta dhe raportim në Senatin Akademik të UMSH.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të	Ngritja e këtij komisioni do të shërbej për nxitjen, promovimin dhe monitorimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në UMSH si edhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi.

tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<p>Në funksion të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit Senati Akademik i UMSH ka miratuar Rregulloren e Përgjithshme, Manualin e SBC, Rregulloren e NJSBCZHK. Plani strategjik i zhvillimit të UMSH si edhe Strategjia e Zhvillimit të Programit MSCAB të cilat plotësojnë kriteret institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Sipas RVB-së për NJSBCZHK “Ajo përbëhet nga drejtuesi dhe 9 anëtarë të cilët kanë mandat 3-vjeçar dhe 1 studentë”, ndërsa referuar tabelës nr. 24 në evidencën nr. 8, konstatohet se 5 anëtarë përfshirë edhe kryetaren kanë 4 vjet në këtë detyrë. Gjithashtu, IAL mund të sigurojë përfshirjen e bashkëpunëtorëve e ekspertëve të jashtëm në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca 1. “Statuti i UMSH” Kreu XI, Neni 53, 84; Evidenca 4. “Rregullore e Organizimit të UMSH” Neni 28, 78, 79; Evidenca 9 Rregullore e NJSBCZHK.pdf; Evidenca 51. “Raporti vjetor NJSBCZHK”; profile: Tabela 24)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>UMSH ka integruar në një njësi Zhvillimin e Kurrikulave si edhe SBC duke menduar që këto dy funksione të koordinohen në shërbim të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Megjithatë sipas RVB-së, në zbatim të akteve rregullative institucionale përsëri pësha bie mbi drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për të marrë masa organizative dhe monitoruese për procesin mësimor dhe kërkimor, por është anashkaluar evidentimi i përgjegjësive konkrete të NJSBCZHK e cila është Njësia e Posaçme e ngritur nga IAL për të monitoruar, shqyrtuar, mbikëqyrë dhe rishikur programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe</p>	



mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Në DVV gjenden nga GVJ evidenca për të dokumentuar punën e NJSBCZHK për çdo fund viti akademik për proceset e ndryshme të planveprimit edhe raportin përmbledhës të gjithë aktivitetit vjetor si dhe sygjerimet e kësaj njësie për çdo aktivitet të vlerësuar lidhur me programin e studimit të MScAB.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Gjatë vizitës në IAL, ekspertët pyetën përfaqësuesit e NJSBCZHK për:			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	a) Shpeshësinë e raportimit në informimin e drejtuesve të njëjësive bazë dhe përmes tyre të gjithë stafin mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së stafit akademik.			
	Përgjigja nga NJSBC ishte se përpilohej një raport vjetor, ndërkohë që studentët anketoheshin në përfundim të semestrit para se të bëhet Provimi. Gjithashtu, në pyetësor ka pyetje për të vlerësuar cilësinë e punës së stafit administrativ nga studentët.			
	Sipas NJSBC, pedagogu njoftohet për rezultatet e arritura dhe nëse ka probleme thërritet nga rektorati. Gjithashtu, “informacioni i përfutur nga këta instrumenta kontrolli pas përpunimit përdoret në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik”.			
	Evidencat e depozituara në DVV janë një raportim për strukturat drejtuese se çfarë detyrash ka kryer kjo njësi dhe një analizë e gjetjeve dhe adresimi i tyre përgjatë procesit të vlerësimit të cilësisë për programin e studimit ashtu siç e kërkojnë standardet dhe vetë statuti UMSH			
	<i>Evidenca 51. “Raporti vjetor NJSBCZHK Evidenca 1. Statuti i UMSH, Neni 53, 84. Evidenca 9. Manuali i NJSBCZHK, neni 4; Evidenca 19. Plan pune për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021; Evidenca 24. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut nga Autoriteti Drejtues.”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>UMSH ka përgjegjësinë t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase tarifat e studimit nga studentët e tij, etj., dhe të sigurojë mbarëvajtjen cilësore të këtij programi studimi jo vetëm deri në diplomimin e studentëve por edhe daljen e tyre në tregun e punës apo sigurimin e trajnimit të vijueshëm të tyre edhe pas diplomimit.</p> <p>Sipas RVB-së, NJSBCZHK raporton tregues, opinione dhe sugjerime që vijnë nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve, sondazheve, e fokus grupeve të studentëve të të gjitha viteve dhe programeve dhe kontakteve të vazhdueshme me ata.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Rol të vecantë luan edhe vlerësimi për programet e studimit nga palë të treta të fushës përkatese nga sektori publik dhe privat.</p> <p>GVJ konstatoi se në raport janë kryer sondazhe apo intervista me aktorë të tregut të punës për punësimin e studentëve të këtij programi pavarësisht se edhe sipas manualit të NJSBCZHK i jepet rol i vecantë vlerësimit të programit të studimit nga palë të treta të fushës përkatese (nga sektori publik dhe privat).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ i këshillon IAL-së që përveç metodave që ai aplikon duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, të tilla si sondazhe e intervista me punëdhënës për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Evidenca 20. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut nga Autoriteti Drejtues; Evidenca 22. Procedura e punës me fokus grupet; Evidenca 12. Manuali i NJSBCZHK, neni 4. Evidenca 7. Analiza e tregut)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik,</p>	

ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike</p>	<p>Referuar RVB nuk shprehet qartë lidhur me këtë standard, por referuar Evidencave të depozituara në AMS mund të evidentojmë se Senati Akademik i UMSH është siguruar që përmes miratimit të Manualit të SBC dhe Rregullores së Përgjithshme të përfshijë aktorë të brendshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit përmes citimit në nenin 4 dhe 5 të Manualit të SBC ku përcaktohet ngritja e GVB dhe në përbërje të tyre të ketë përfaqësues të studentëve, stafit akademik dhe atij ndihmësakademik apo administrativë.</p> <p>GVJ në Manualin e SBC konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në nenin 2 të tij është përcaktuar përbërja e NJSBC e cila nuk ka asnjë përfaqësim nga aktorë të jashtëm të interesuar të tillë si punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj. • Në nenin 6 të tij është përcaktuar cikli i Vetëvlerësimit të Brendshëm të Cilësisë si rregull një herë në 6 vjet duke ju referuar edhe ligjit të arsimit të lartë, dhe vetëm vlerësime të pjesëshme edhe më shpesh nëse do të jetë e nevojshme. Kjo bie ndesh me frymën e ligjit dhe standardet e monitorimit të cilësisë të cilat janë në përfaqje të metodologjisë me bazë riskun dhe jo me cikël. Në nenin 106 të ligjit të arsimit të lartë citohet: “Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të

<p>të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>zgjasë më shumë se 6 vjet”, duke shprehur një tavan të sipërm për numrin e viteve maksimale të mundëshme për akreditim nga bordi i ASCAL por aspak për t’u aplikuar kjo si tregues nga strukturat brenda IAL të cilat kanë detyrë dhe përgjegjësi për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk ka evidenca (dokumenta) që tregojnë përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj dhe çfarë janë reflektuar në realitet nëse ka pasë të tilla takime.</p> <p><i>(Ligji i Arsimit të Lartë (80-2015 i datës 22.07.2015): Evidenca 1 Statuti i UMSH.pdf; Evidenca 2 Rregullore e Organizimit të UMSH.pdf; Evidenca 9. Manuali i NJSBCZHK ;)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera të kësaj fushe vlerësimi në RVB nuk janë dhënë përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret por ka përsëritje të përgjigjeve, si edhe ka mungesë të referencave dhe evidencave. Të gjitha sa më sipër e vendosin në vështirësi vlerësimin nga ana e GVJ-së.</p> <p>Sipas statutit dhe Rregullores së përgjithshme të UMSH nuk ishte e qartë nëse ishte detyrim ekzistenca e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë së Institucionit, si organ përgjegjës para Senatit për sigurimin e cilësisë në këtë IAL. Nga GVJ sipas përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit u konstatua se nuk ekziston ky komision në nivel Institucional. Megjithatë sipas NJSBC u saktësua se UMSH nuk e ka këtë lloj komisioni.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Bazuar ne RVB, UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion pretendentëve (drejtues, pedagogë, të tjerë të interesuar). Tërheqja e mendimit të studentëve në UMSH ka</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar ne RVB, UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion pretendentëve (drejtues, pedagogë, të tjerë të interesuar). Tërheqja e mendimit të studentëve në UMSH ka</p>



<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>shërbyer për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së pedagogëve dhe sipas GVB në ndonjë rast ka pasë edhe marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndërsa NJSBC nuk na konfirmoi ndonjë gjetje materiale të marrë nga studentët dhe si rrjedhim nuk ka pasë asnjë masë të marrë. Kjo për GVJ do të thotë se ka paqartësi edhe brenda vetë IAL-së lidhur me punën e NJSBC. Sipas RVB konstatohen disa rast/gjetje të konsideruara si problemet më kryesore të cilat kanë qënë të lidhura me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimin, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Si edhe për ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve në UMSH është arritur përmes një larmie formash, nga trajnimi deri të rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi.</p> <p>Një tjetër kërkesë e një kriteri në këtë standard është për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit. GVJ gjatë vlerësimit të RVB, website të IAL-së, si edhe evidencave të depozituara në AMS nuk konstaton që IAL të ketë plotësuar kërkesën e këtij kriteri duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të UMSH të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. Në këtë mënyrë nuk sigurohet transparenca për studentët dhe të gjithë palët e interesuara.</p> <p>Në përfundim, GVJ i sugjeron IAL-së, të merren masat për:</p> <p><i>Publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>				

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:


1. Staf i akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi ka një nivel të lartë kualifikimi në fushën akademike dhe kërkimore-shkencore që është në përputhje me natyrën e këtij programi studimi;
2. UMSH disponon një infrastrukturë moderne dhe të pajisur me mjete të teknologjisë së informacionit në shërbim jo vetëm të procesit mësimor por edhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse të studentëve dhe pedagogëve. Disponohen disa laboratorë informatike, programe aplikative të instaluar në kompjutera, internet wireless falas në mjediset e institucionit, etj;
3. UMSH ndjek politika mbështetëse për studentët, nëpërmjet bursave të studimit për studentët e ekselencës, për talentet e spikatura, për studentët me nevoja të veçanta ekonomike, sociale e shëndetsore;
4. UMSH ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi jo vetëm me institucionet publike dhe bizneset në vend, por edhe me universitetet si brenda dhe jashtë vendit, duke rritur kështu mundësitë për mobilitete të studentëve dhe të stafit akademik;
5. Pjesëmarrja e UMSH si partner në projekte ndërkombëtare për ngritje kapacitetesh të financuara nga EU, e ka afruar më shumë institucionin drejt realizimit të synimit të tij strategjik për ndërkombëtarizimin;

b. Pika të dobta:

1. Caktimi i rolit të koordinatorit të programit tek një person i vetëm për të gjitha programet e studimit në nivel njësie kryesore. Këtë rol e ka Koordinatori i Fakultetit, detyrat e të cilit janë të orientuara kryesisht drejt ecurisë dhe zhvillimit të programit dhe informimit të titullarit të njësisë kryesore, por nuk janë aq të qarta në lidhje me marrëdhëniet me studentët; (*Standardi II.1, Kriteri 2*)
2. Mungesa e informacioneve në faqen e web-it të institucionit në lidhje me veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave dhe dokumentat që prodhon kjo njësi, të tilla si raportet për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve; (*Standardi III.1, Kriteri 4*)
3. Nuk është mundur ende përfshirja e studentëve, alumni, punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj, në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. (*Standardi VI.1, Kriteri 2*)

Rekomandime:

1. Njësia kryesore të shpërndajë rolin dhe përgjegjësinë e koordinatorit të programit nëpër departamente, në mënyrë që të ketë më shumë persona të angazhuar në këtë rol, duke mundur që roli i tij të jetë më i qartë dhe më pranë studentit;
2. Të publikohen në faqen e web-it të institucionit informacione dhe dokumenta që lidhen me veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, si p.sh. rezultatet e anketave të studentëve për vlerësimin e programit të studimit;



3. Rritje e Mundësive për financime më shumë të punës kërkimore dhe botuese në universitet si edhe ofrimi i shërbimeve për të tretët-si fond shtesë për motivim stafi dhe investime ne botime dhe punë kërkimore;
4. Institucioni duhet të përfshijë studentë, studentë, alumni ose ekspertë të jashtëm në aktivitetet e tij për të përmirësuar cilësinë e kurrikulave;

Conclusions of the Evaluation Process of the study program “Bachelor in Business Informatics”

a. Strengths and affirmations:


1. The academic staff engaged in this study program has a high level of qualification in the academic field and research that is consistent with the nature of the curriculum of this program;
2. MUA has a modern infrastructure, equipped with information technology tools, in the service of the teaching and learning process, but also in supporting other activities of students and lecturers. There are several computer laboratories, application programs installed on computers, free wireless internet services in the premises of the institution, etc;
3. MUA follows support policies for students, through scholarships for excellent students, for outstanding talents, for students with special economic, social and health needs, etc;
4. MUA has signed a series of cooperation agreements not only with local public institutions and businesses, but also with universities both inside and outside the country, that has increased the opportunities for mobility of students and academic staff;
5. The participation of MUA as a partner in international projects for capacity building financed by the EU, has brought the institution closer to the realization of its strategic goal for internationalization;

b. Weaknesses:

1. The role of program coordinator is assigned to a single person for all programs at the faculty level. This role is assigned to Faculty Coordinator, whose duties are mainly oriented towards the progress and development of the program and informing the Dean but are not so clear regarding to the relations with students. *(Standard II.1, Criterion 2)*
2. The lack of information on the institution's website regarding the activity of the Internal Quality Assurance and Curriculum Development Unit and the documents that this unit produces, such as reports for the analysis of the results of the questionnaires from the student survey. *(Standard VI.1, Criterion 2)*
3. Related to the activity of the Internal Quality Assurance the institution doesn't involve students, alumni or external experts; *(Standard III.1, Criterion 4)*

Recommendations:

1. The program coordinator should be appointed a person close to the department that offers the study program, so that his role and responsibilities will be clearer related to that program and closer to the students;



2. To publish on the website of the institution information and documents related to the activity of the Internal Quality Assurance and Curriculum Development Unit, such as the results of student surveys for the evaluation of the study program;
3. To increase financial support for more research and publications possibilities in order to increase staff motivation;
4. Related to the activity of the Internal Quality Assurance the institution should involve students, alumni or external experts in its activities in order to improve the quality of the curricula;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

